**VENDIM**
**Nr. 770, datë 26.12.2018**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT TË PERSONAVE 2018–2020**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2018 - 2020, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë, Ministria Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

## HYRJE

Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave shpreh përkushtimin e shtetit dhe qeverisë shqiptare, të institucioneve shtetërore dhe joshtetërore, të qindra aktorëve antitrafikim që punojnë në strukturat publike dhe jopublike, për të minimizuar fenomenin e trafikimit të personave.

Ky dokument, nga viti 2001 kur u miratua dhe Strategjia e parë në këtë drejtim e deri më sot, prezanton një serë arritjesh në fushën e luftës kundër trafikimit të personave: numri i viktimave shqiptarë të trafikimit që shfrytëzohen jashtë ka rënë ndjeshëm, trafikimi dënohet si një krim i rëndë, sektorë dhe profesionistë të specializuar janë angazhuar me hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e tij në polici, prokurori dhe gjykata. Në Shqipëri, iu jepet mbrojtje e pakushtëzuar për të bashkëpunuar me drejtësinë, viktimave të trafikimit që kanë nevojë për të, dhe riintegrimi i viktimave është në shumicën e rasteve të asistuara i suksesshëm. Qeveria mbështet 4 qendrat publike dhe jopublike të pritjes dhe riintegrimit të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit dhe çdo vit financon një pjesë të funksionimit të shërbimeve mbrojtëse për to.

Është rritur bashkëpunimi me të gjithë partnerët kombëtarë, ndërkombëtarë dhe rajonalë për të goditur dhe parandaluar trafikimin dhe shfrytëzimin ndërkombëtar të njerëzve nëpërmjet konventave të nënshkruara, Marrëveshjeve dhe protokolleve të bashkëpunimit, shkëmbimit të informacionit dhe komunikimeve të drejtpërdrejta ndërmjet agjencive të ngarkuara shtetërore. Ne jemi të ndërgjegjshëm se trafikimi i personave është një e keqe globale, e cila kërkon një qasje gjithpër-fshirëse dhe një partneritet të vërtetë kolegjial.

Pavarësisht këtyre arritjeve gjejmë përpara shumë sfida për të kapërcyer e shumë mundësi për përmirësim. Ky dokument është përgjigja që qeveria shqiptare dhe partnerët e saj i japin këtij fenomeni të rëndë, por të kapërcyeshëm. Trafikimi është një fenomen që arrin t'i përshtatet dinamikave të zhvillimit e vit pas viti merr forma të ndryshme, duke shfrytëzuar çdo vakum ligjor apo probleme sociale të një vendi. Ky dokument është produkt i një analize të kujdesshme të arritjeve të deritanishme, të problemeve dhe të sfidave që kemi përpara, të cilat jemi të vendosur t'i fitojmë.

Përgjigja shqiptare kundër trafikimit të personave është gjithëpërfshirëse, ajo heton e ndjek penalisht trafikantët, mbron viktimën e çon përpara politika e iniciativa parandaluese ndaj trafikimit, duke mbajtur të koordinuar të gjitha këto përpjekje. Praktikat e vëna tashmë në punë, mekanizmat që ndërveprojnë e legjislacioni i miratuar deri më sot do të bëjnë të mundur që këto përqasje të japin rezultate më të mira. Sigurisht dinamikat lokale dhe globale na kushtëzojnë të kemi një qasje të adresuar qartazi, si dhe të mësojmë gjëra të reja rreth këtij fenomeni, por ky dokument është një plan orientues e koordinues për t'u përballur me sfidat që ne hasim.

Ne vazhdojmë të jemi të angazhuar për të përshirë sa më shumë struktura nga niveli qendror në atë nivel lokal për t'u ardhur në ndihmë të rinjve, fëmijëve, grave dhe meshkujve viktima të trafikimit, fëmijëve të viktimave të trafikimit, me qëllim integrimin e tyre social-ekonomik. Këto përpjekje na venë ne në një nivel me përpjekjet evropiane dhe ndërkombëtare për të ndaluar trafikimin e personave dhe skllavërinë moderne.

**SHKURTIMET**

| | |
|---|---|
| AP | Autoriteti Përgjegjës |
| ASHDMF | Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës |
| DAR | Drejtoritë Rajonale Arsimore |
| DPPSH | Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit |
| DSHSB | Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashki |
| DVKM | Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin |
| DRSHSSH | Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror |
| IOM | Organizata Ndërkombëtare për Migracionin |
| ICITAP | Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnim në Hetimet Penale |
| ICMPD | Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migrimit |
| KB/UN | Kombet e Bashkuara |
| KK | Koordinatori Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave |
| KRAT | Komitetet Rajonale Antitrafikim |
| KSH | Komiteti Shtetëror |
| KKSAT | Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Antitrafik |
| MB | Ministria e Brendshme |
| MKR | Marrëveshja për Mekanizmin Kombëtar të Referimit |
| MEPJ | Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme |
| MD | Ministria e Drejtësisë |
| MFE | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |
| MSHMS | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale |
| MASR | Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë |
| MEPJ | Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme |
| MKR | Mekanizmi i referimit të rasteve të dhunës në familje në nivel lokal |
| MMDHF | Mekanizmi i Mbrojtjes ndaj Dhunës së Fëmijëve |
| NJMF | Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve |
| OSBE | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë |
| OJF | Organizata Jofitimprurëse |
| PKK | Pika e Kalimit Kufitar |
| PMF | Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijëve |
| PSV | Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit |
| SHSSH | Shërbimi Social Shtetëror |
| SHKP | Shërbimi Kombëtar i Punësimit |
| SPZ | Specialisti i policisë së zonës |
| UNODC | Zyra e Kombeve të Bashkuara për Krimin dhe Drogat |
| VT | Viktimë trafikimi |
| VMT | Viktimë e mundshme trafikimi |
| ZKKA | Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave |
| ZRSHSSH | Zyra Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror |

**PARIMET MBI TË CILAT MBËSHTE-TET PLANI I VEPRIMIT:**

- Përgjegjësia e Qeverisë
- Qasja ndërsektoriale dhe pjesëmarrja e shoqërisë civile
- Bashkërendimi ndërinstitucional dhe veprimtaritë ndërsektoriale në nivel qeveritar, si dhe mes Qeverisë, OJF-ve dhe ON-ve
- Qasje dhe trajtim i viktimave, i mbështetur tek të drejtat e njeriut
- Mbrojtja e të drejtave të fëmijës
- Mbrojtja e të drejtave të grave dhe burrave të trafikuar dhe në rrezik trafikimi
- Kostimi dhe financimi sistematik dhe i qëndrueshëm i aktiviteteve

**SYNIMET STRATEGJIKE DHE OBJEK-TIVAT SPECIFIKE:**

Plani i Veprimit ndahet në katër fusha:

1. Ndjekja penale
2. Mbrojtja

3. Parandalimi
4. Bashkërendimi
Më në detaje, sipas shtyllave të PKV-ve parashikohet:

**1. Hetimi dhe ndjekja penale**

Trafikimi i personave është një krim i rëndë dhe legjislacioni shqiptar e njeh si të tillë. Aktivitetet e këtij Plani Veprimi udhëzojnë të gjithë strukturat përkatëse të zbatojnë me përpikëri legjislacionin në fuqi. Ky Plan Veprimi udhëzon autoritetet përgjegjëse të plotësojnë dhe përmirësojnë legjislacionin, të vënë në lëvizje dhe të shfrytëzojnë të gjithë mekanizmat e mundshëm dhe të trajnojnë strukturat përkatëse për të bërë të mundur ndalimin e të gjitha formave të trafikimit duke dënuar çdo formë të shfrytëzimit të njerëzve.

**2. Mbrojtja dhe asistenca e viktimave**

Aktivitete ambicioze janë parashikuar në këtë Plan Veprimi për të bërë të mundur dhënien e mbrojtjes dhe ndihmës, jo vetëm ndaj atyre viktimave që bashkëpunojnë me drejtësinë, por çdo personi i cili është identifikuar si viktimë/viktimë e mundshme trafikimi. Sigurisht një rëndësi e veçantë i jepet identifikimit dhe referimit duke mobilizuar të gjitha mekanizmat e mundshëm identifikues në vend dhe duke dhënë udhëzimet dhe burimet e nevojshme për këtë qëllim. Një përqasje e tillë nuk mund të arrihet pa forcuar partneritetin dhe urat e bashkëpunimit mes palëve përgjegjëse për identifikim dhe pa forcuar dhe rritur burimet e strukturave të shërbimit.

**3. Parandalimi**

Aktivitetet parandaluese në këtë Plan Veprimi adresojnë rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimit publik lidhur me legjislacionin kombëtar e Konventat Ndërkombëtare antitrafikim, me të gjitha format e trafikimit të personave (trafikimi i brendshëm, shfrytëzimi për punë të detyruar të fëmijëve dhe të rriturve, lypja nga fëmijët, fëmijët në situatë rruge etj.), si dhe pasojat e tij.

**4. Koordinimi**

Ky Plan Veprimi mobilizon dhe kërkon angazhimin e shumë agjencive, që operojnë në këtë fushë. Mungesa e një koordinimi dhe monitorimi të aktiviteteve të parashikuara e bën të pamundur analizimin dhe vlerësimin e implementimit të aktiviteteve të reja. Koordinimi dhe partneriteti, gjithashtu, operojnë bashkë. Agjencitë shtetërore kanë nevojë për mbështetjen e njëra tjetrës në kryerjen e shumë aktiviteteve. Gjithashtu, agjencitë shtetërore kanë nevojë për mbështetjen e mekanizmave të shoqërisë civile të cilët plotësojnë detyrimet e palëve. Për këtë qëllim, Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafikim merr angazhimin e plotë për të kryer një koordinim sa më efikas të aktiviteteve të parashikuara në këtë Plan Veprimi.

**PËRKUFIZIME**

"Viktimë trafikimi" (VT): Sipas germës "e" të nenit 4, të ligjit 9642 datë 20.11.2006 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore", është personi objekt i trafikimit të qenieve njerëzore.

"Viktimë e mundshme trafikimi" (VMT), është personi për të cilin/të cilën, agjencitë/institucionet përgjegjëse për identifikim fillestar, bazuar në treguesit/indikatorët/dritën e rrethanave të veçanta të rasteve, në të cilën, të paktën tre ose më shumë elementë përbëjnë dyshimin e arsyeshëm se personi mund të jetë trafikuar.

Fëmijë"[1], është çdo person nën moshën 18 vjeç.

"Fëmijë në nevojë për mbrojtje", është personi nën moshën 18 vjeç, pavarësisht fitimit të zotësisë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi, i cili mund të jetë viktimë e abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit, diskriminimit, dhunës apo ndonjë veprimtarie tjetër kriminale, si edhe individi nën moshën e përgjegjësisë penale, i cili dyshohet se ka kryer ose akuzohet se ka kryer një vepër penale, si dhe fëmijët në konflikt me ligjin.

"Mbrojtje e personave të trafikuar", përfshin të gjitha veprimet e kryera nga punonjës të institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore dhe të institucioneve joshtetërore, anëtare ose jo të Mekanizmit Kombëtar të Referimit për pritjen, identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe ndihmën për rehabilitimin dhe riintegrimin e sigurt të personave të trafikuar në përputhje me PSV-të.

"Autoriteti Përgjegjës" (AP), është strukturë e ngritur me udhëzimin e përbashkët nr. 3799, datë 8.7.2014[2] "Për ngritjen e autoritetit përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit". Autoriteti Përgjegjës përbëhet nga përfaqësues të ministrive nënshkruese të udhëzimit për ngritjen e tij, si dhe një përfaqësues i Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Antitrafik.

---

[1] Sipas nenit 3 "Përkufizime" të ligjit nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

[2] I Ministrit të Punëve të Brendshme, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit, i Ministrit të Punëve të Jashtme, i Ministrit të Shëndetësisë, i Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

"Ri/integrim i personave të trafikuar", është procesi i rikuperimit dhe përfshirjes sociale dhe ekonomike pas një përvoje trafikimi. Përfshin vendosjen në një mjedis të sigurt dhe të qëndrueshëm, akses në standard jetese të arsyeshëm, mirëqenie fizike dhe mendore dhe mundësi për zhvillim personal, social dhe ekonomik dhe akses në mbështetje sociale dhe emocionale. Një aspekt qendror i ri/integrimit të suksesshëm është ai i fuqizimit, mbështetjes së viktimave për të zhvilluar aftësitë drejt pavarësisë dhe vetëmjaftueshmërisë dhe për t'u përfshirë në mënyrë aktive në rikuperimin dhe ri/integrimin e tyre.

"Trafikim i personave", sipas nenit 110/a të Kodit Penal të RSH-së është "Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit".

"Trafikimi i të miturve", sipas nenit 128/b të Kodi Penal, të RSH-së është "Rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit".

"I/e mitur[3]", sipas legjislacionit shqiptar penal dhe civil, është çdo person nën moshën 18 vjeç.

"I/e mitur i/e pashoqëruar", është i mituri i huaj, i cili hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë, i pashoqëruar nga një person madhor përgjegjës, sipas ligjit dhe për sa kohë që nuk merret efektivisht në përkujdesje prej tij, ose i mituri që lihet i pashoqëruar, pas hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë[4].

"Fëmijë i pashoqëruar", është i mituri që është ndarë nga të dy prindërit ose të afërmit e tjerë të familjes dhe për të cilin nuk kujdeset ndonjë person madhor, sipas këtij ligji[5].

"Azilkërkues", është çdo i huaj apo person pa shtetësi, që shpreh në çfarëdolloj mënyre se nuk dëshiron të kthehet në vendin e tij, si dhe çdo i huaj apo person pa shtetësi që ka paraqitur një aplikim për azil në Republikën e Shqipërisë, për të cilin nuk është marrë ende një vendim përfundimtar.[6]

"Shërbime të kujdesit shoqëror", është një sistem i integruar dhe i organizuar përfitimesh dhe lehtësish, të cilat ofrohen nga profesionistë të fushave përkatëse të subjekteve publike ose jopublike, me qëllim sigurimin e mirëqenies, pavarësisë dhe përfshirjes shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.[7]

"Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH)", është institucion në varësi të ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale. Monitoron zbatimin e legjislacionit të shërbimeve shoqërore në të gjithë vendin, nëpërmjet strukturave të njësisë qendrore dhe drejtorive rajonale.[8]

"Strehëzat/qendrat për viktimat e trafikimit", janë institucione rezidenciale shtetërore ose joshtetërore të licencuara sipas legjislacionit në fuqi për të dhënë shërbime ndihme dhe mbrojtjeje për personat viktima të mundshme të trafikimit, viktimat e trafikimit dhe persona në rrezik trafikimi. Strehëzat/qendrat mund të jenë të hapura ose të mbyllura, mund të ofrojnë qëndrim afat-shkurtër ose afat-gjatë; dhe/ose përdoren për rastet e emergjencave ose të mbështetjes për riintegrim. Qendrat mund të emërtohen pritëse, reintegruese apo pritëse - riintegruese). Ofrimi dhe dhënia e shërbimeve në strehëza bëhet në përputhje me VKM nr. 195, datë11.4.2007 "Për miratimin e standardeve të përkujdesit shoqëror në qendrat rezidenciale për personat e trafikuar dhe në rrezik trafikimi".

"Baza e të dhënave për viktimat e trafikimit SIVET", është një bazë të dhënash e integruar në sistemin TIMS, i cili është i vetmi burim zyrtar për statistikat në lidhje me viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit.

**KUADRI LIGJOR**

*Legjislacioni ndërkombëtar*

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
- Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Individëve për sa i përket Përpunimit Automatik të të Dhënave Personale
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut[9]

---

[3] I mitur- i referohet kurdoherë fëmijës
[4] Sipas pikës 31 të nenit 3 të ligjit nr.108/2013 "Për të huajt", i ndryshuar
[5] Sipas nenit 3 "Përkufizime" të ligjit nr.18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"
[6] Sipas pikës ç, të nenit 3 të ligjit nr. 121/2014 "Për Azilin në Republikën e Shqipërisë"
[7] Sipas pikës 1 nenit 3 të ligjit nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"
[8] Neni 32 i ligjit nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"
[9] Ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996 "Për Ratifikimin e Konventës Europiane Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore", Fletore Zyrtare nr. 20, viti i botimit 1996.

- Protokolli shtesë i Konventës për të Drejtat e Fëmijës për Shitjen e Fëmijës, Prostitucionin e Fëmijës dhe Pornografinë e Fëmijës [10]

- Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Transnacional/ "Protokolli Shtesë mbi 'Parandalimin, shtypjen, dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, në mënyrë të veçantë të grave dhe fëmijëve"[11]

- Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Transnacional/ "Protokolli kundër Kontrabandimit të Emigrantëve në Rrugë Tokësore, Ajrore dhe Detare"[12]

- Konventa e OKB për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave CEDAW[13]

- Konventa e Këshillit të Evropës "Për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore"[14]

- Protokolli Opsional i Konventës për të Drejtat e Fëmijës "Mbi shitjen, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve"

- Konventa e Vjenës mbi marrëdhëniet konsullore, datë 24.4.1963

- Konventa e Konferencës së Hagës "Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit"[15]

- Konventa e Konferencës së Hagës "Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin, në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve"[16]

- Konventa e Konferencës së Hagës 'Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve"[17]

- Konventa e Konferencës së Hagës "Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore"[18]

- Konventa e Konferencës së Hagës "Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve në lidhje me detyrimet ushqimore"[19]

- Konventa e Këshillit të Evropës "Për mbrojtjen e fëmijëve kundër shfrytëzimit dhe abuzimeve seksuale"[20]

- Konventa e Këshillit të Evropës "Për statusin juridik të fëmijëve të lindur jashtë martesës"[21]

- Konventa e Këshillit të Evropës "Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve"[22]

- Konventa e Konferencës së Hagës "Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes" (miratuar në parim, nga Këshilli i Ministrave, në mbledhjen e datës 26.05.2011).

- Konventa e Këshillit të Evropës "Kundër Trafikimit të Organeve Njerëzore"[23]

- Konventat e ILO-s nr. 29[24], 138[25] dhe 182[26]

**Legjislacioni vendas**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

- Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale

- Më specifikisht në legjislacionin vendas është marrë në konsideratë:

- Kodi Penal: neni 110/a "Trafikimi i të rriturve", neni 128/b "Trafikimi i të miturve", Neni 298 "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve", neni 124/b " Keqtrajtimi i të miturit", Neni 117 "Pornografia"

- Ligji nr. 8920, datë 11.07.2002 "Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional dhe dy protokolleve shtesë"

- Ligji nr. 9265, datë 29.07.2004 "Për ratifikimin e Konventës Evropiane "Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme"

- Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar

- Ligji nr. 108/2014 " Për policinë e shtetit", i ndryshuar

---

[10] Ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 9834, datë 22.11.2007 "Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së "Për të Drejtat e Fëmijëve", Për Shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin dhe Pornografinë me Fëmijë", Fletore Zyrtare nr. 165, Viti i botimit 2007.

[11] Ligji nr. 8920, datë 11.07.2002, Fletore Zyrtare nr. 41, korrik 2002.

[12] www.uncij.org/documents/conventions

[13] Ratifikuar me ligjin nr. 1769, datë 11.05.1994

[14] Ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 9642, datë 20.11.2006 "Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore"", Fletore Zyrtare nr. 132, viti i botimit 2006

[15] Aderuar me ligjin nr. 8624, datë 24.06.2000

[16] Aderuar me ligjin nr. 9443/2005

[17] Aderuar me ligjin nr. 9446/2005

[18] Aderuar me ligjin nr. 10397, datë 17.3.2011

[19] Aderuar me ligjin nr. 10398, datë 17.3.2011

[20] Ratifikuar me ligjin nr. 10071, datë 9.02.2009

[21] ratifikuar me ligjin nr. 10424, datë 02.06.2011

[22] Ratifikuar me ligjin nr. 10425, datë 02.06.2011

[23] Ratifikuar me ligjin nr. 150/2015, datë 21.12.2015

24 Konventa e ILO nr.C29 "Për punën e detyrueshme", ratifikuar

25 Konventa e ILO nr. 138 "Mosha minimale për pranimin në punë" ratifikuar më datë 16.2.1998

26 Konventa nr.C182 "Për ndalimin dhe veprimet e menjëhershme për eliminimin e formave më të këqija të punës së fëmijëve", ratifikuar më datë 2.8.2001

- Ligji nr. 108/2013 "Për të Huajt", i ndryshuar
- Ligji nr. 121/2014 "Për Azilin në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji nr. 23/2015 "Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë"
- Ligji nr. 10173, datë 22.10.2009 "Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë", i ndryshuar
- Ligji nr. 9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e Pastrimit të Parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar
- Ligji nr. 10192, datë 3.12.2009 "Për Parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit përmes masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar.
- Ligji nr. 111/2017 "Për ndihmën Juridike"
- Ligji nr. 98/2017 "Për tarifat gjyqësore në RSH"
- Ligji nr. 37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur"
- Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"
- Ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar"
- Ligji nr. 10 383, datë 24.2.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
- Vendimi nr. 195, datë 11.4.2007 i Këshillit të Ministrave "Standardet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për Personat e Trafikuar ose në Rrezik Trafikimi në Qendrat Rezidenciale"
-Vendimi nr. 933, datë 2.07.2008 i Këshillit të Ministrave "Për përfaqësimin e Ministrisë së Brendshme me oficerë kontakti në Britaninë e Madhe, Belgjikë, Itali, Greqi, Turqi, Kosovë dhe Europol", i ndryshuar
- Udhëzimi i përbashkët nr. 3799, datë 8.7.2014 "Për ngritjen e Autoritetit përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit"
- Urdhri nr. 805, datë 1.8. 2017, i ministrit të Brendshëm "Për forcimin e kontrollit të shtetasve shqiptarë që kalojnë kufirin shtetëror"
- Memorandumi i Mirëkuptimit i Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Prezencës së Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunimin në Evropë në Shqipëri (OSCE) "Për promovimin dhe zbatimin e Kodit të Sjelljes për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual në Turizëm" (nënshkruar në vitin 2007)
- Marrëveshja e Bashkëpunimit për Funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit të personave (MKR), datë 15 qershor, 2012

**BURIMET FINANCIARE**

Plani Kombëtar i Veprimit të Luftës kundër Trafikimit të Personave do të zbatohet në periudhën 2018-2020. Për të mbështetur zbatimin e tij është parashikuar kostoja për secilën veprimtari, objektiv specifik, synim strategjik dhe fushë. Kostoja e përgjithshme për realizimin e Planit Kombëtar të Veprimit është rreth 488.9 milionë lekë ose afërsisht 3.67 milionë euro[27].

Kostimi u realizua duke u mbështetur në koston e secilit aktivitet të pasqyruar në planin e veprimit, kohështrirjen e tij, si dhe treguesit për monitorimin e strategjisë. Për kostimin e planit të veprimit u përdor një metodologji e kombinuar, pasi plani përfshin disa sektorë. Metodologjia kryesore e përdorur është kostimi i bazuar në aktivitete, por ndërkohë janë marrë parasysh për shumë veprim-tari shpenzimet mesatare sipas PBA për aktivitete që janë përfshirë në buxhet dhe për aktivitete të ngjashme. Për llogaritjen e shpenzimeve për aktivitetet kryesore është vepruar si më poshtë:

<u>Llogaritja e shpenzimeve për aktiviteteve që lidhen me hartimin dhe rishikimin e legjislacionit, monitorimin dhe funksionimin e strukturave të përhershme etj.</u>, është mbështetur në shpenzimet e vazhdueshme për pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore, shpenzime të tjera operative.

<u>Llogaritja e shpenzimeve për "aktiviteteve specifike" ose i iniciativave specifike të ngjashme</u>. Në këto raste, kostimi shpesh është i limituar, pra ai përdoret një herë të vetme, siç ndodh në rastin e studimeve, fushatave ndërgjegjësuese, programeve të trajnimit për përfitues jashtë strukturave të policisë,etj. Vlerësimi i shpenzimeve për këto aktivitete u bazua kryesisht në natyrën e aktiviteteve dhe kostot që ofron tregu për shërbime të tilla.

Në llogaritjen e shpenzimeve për trajnime është mbajtur në konsideratë kosto e trajnimit të vazhduar. Si kosto për njësi janë përdorur kostot e trajnimit të strukturave të policisë[28] MB dhe/ose kostot e aplikuara për trainime të ngjashme në të shkuarën.

Për atë pjesë të aktiviteteve ku informacioni nuk ishte i plotë, është ndjekur metoda e vlerësimit për analogji,

---

[27] Kursi i këmbimit 1 euro = 133 lekë
[28] Sipas PBA 2018-2020

ose me fjalë të tjera janë marrë në konsideratë shpenzimet e bëra për aktivitete të ngjashme në të shkuarën.

Për të realizuar buxhetimin u konsultua gjithashtu dokumenti i PBA 2018-2020, buxheti për vitin 2018, buxhete për aktivitete të ngjashme të zbatuara nga institucione, donatorë apo organizata jofitimprurëse në të shkuarën.

Plani i Veprimit përfshin një buxhet për zbatimin e çdo veprimtarie. Në varësi të llojit të veprimtarisë, Plani i Veprimit ka specifikuar burimet e financimit:

*1. Financimin nga buxheti* (buxheti i ministrive të linjës, buxheti i NjVQV, buxheti i të gjitha institucioneve që financohen nga buxheti i shtetit) për masat që kanë si objekt të drejtëpërdrejtë VT / VMT ose që vijnë nga buxheti i përgjithshëm dhe kontribuojnë në përpjekjet për integrimin e VT/VMT.

*2. Financimi nga donatorët* për ato veprimtari kostot e të cilave mbulohen nga fonde të donatorëve, pavarësisht nëse kanalizohet përmes buxhetit ose organizatave të shoqërisë civile që ofrojnë shërbimet në fusha e caktuar.

*3. Nevojat për fonde,* për ato aktivitete që nuk janë të buxhetuara në buxhetin afatmesëm.

- Buxheti i përgjithshëm për zbatimin e Planit është reflektuar në disa forma:
- Buxheti i përgjithshëm sipas viteve për secilin aktivitet, objektiv specifik, qëllim strategjik dhe burimeve të financimit.
- Buxheti i detajuar sipas aktiviteteve, treguesve, burimeve të financimit dhe institucioneve përgjegjëse.
- Buxheti i kërkuar për zbatimin e Planit ka një shtrirje pak a shumë uniforme për periudhën 2018-2020 (fig.1).

**Figura 1. Buxheti në % për periudhën 2018-2020**




- Nga llogaritjet rezulton që buxheti i shtetit me burimet në dispozicion mund të mbuloj 87.1% të kostove së përgjithshme për zbatimin e PKV.
- Tabela 1 paraqet kosto e përgjithshme dhe nevojat për financim për periudhën 2018-2020.
- Buxhetin më të madh e kërkon fusha e mbrojtjes 61.6%.
- Nevojat për fonde janë në masën 11.7 për qind të kostos totale ose 57.3 milionë lekë.

**Tabela 1: Kostot dhe burimet e financimit 2018-2020**

| PËRSHKRIMI | VITI BUXHETOR | | | | FINANCUAR NGA | | | Nevojat për | Llogaria e Shpenzimeve | | | Fusha |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Fushat | VITI 2018 | VITI 2019 | VITI 2020 | TOTALI | Qeveria | Donatorët | Totali | Fonde LEKË | 600-601 | 602-608 | 230-231 | Fushat ne % |
| Ndjekja Penale | 24,021,688.00 | 25,747,698.00 | 23,971,308.00 | 73,740,694.00 | 61,221,844.00 | 0.00 | 61,221,844.00 | 12,518,850.00 | 35,985,637.00 | 30,455,057.00 | 7,300,000.00 | 15.1% |
| Mbrojtja | 99,027,892.00 | 99,123,274.40 | 102,877,433.65 | 301,028,600.05 | 282,775,900.05 | 4,877,100.00 | 287,653,000.05 | 13,375,600.00 | 177,729,964.00 | 106,548,636.05 | 16,750,000.00 | 61.6% |
| Parandalimi | 25,773,646.80 | 25,260,190.00 | 25,152,802.00 | 76,186,638.80 | 61,088,190.80 | 900,000.00 | 61,988,190.80 | 14,198,448.00 | 31,245,495.44 | 44,941,143.36 | 0.00 | 15.6% |
| Bashkërendimi | 8,213,948.00 | 15,485,736.00 | 14,221,188.00 | 37,920,872.00 | 20,707,432.00 | 0.00 | 20,707,432.00 | 17,213,440.00 | 34,161,732.00 | 3,759,140.00 | 0.00 | 7.8% |
| **TOTAL (1+2+3+4)** | **157,037,174.80** | **165,616,898.40** | **166,222,731.65** | **488,876,804.85** | **425,793,366.85** | **5,777,100.00** | **431,570,466.85** | **57,306,338.00** | **279,122,828.44** | **185,703,976.41** | **24,050,000.00** | 100.0% |
| Në % | **32.1%** | **33.9%** | **34.0%** | | **87.1%** | **1.2%** | | **11.7%** | **59.0%** | **35.4%** | **5.6%** | |

# NDJEKJA PENALE

## 1. SYNIMI STRATEGJIK:

**Synimi Strategjik 1: Rritja e numrit të çështjeve penale të suksesshme të Trafikimit të Personave dhe rikthimi i të drejtave të viktimave**

**OBJEKTIVI SPECIFIK (1.a) Garantimi i përputhjes së legjislacionit kombëtar penal dhe procedural penal mbi trafikimin e personave me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.**

**TREGUESIT: % e amendamenteve të propozuara që kanë hyrë në fuqi**

| Nr. | Veprimtari dhe nënveprimtari | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto (*në mijëra lekë*) | Burimi i financimit (*në mijëra lekë*) | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për fonde |
| 1.(a).1 | Ndryshimi i nenit 52/a të Kodit Penal për të qenë në përputhje me klauzolën e Konventës së KE-së për përjashtimin nga dënimi të VT | MB<br>MD<br>DPPSH<br>PP | 2018-2019 | Neni i ndryshuar;<br>Hyrja në fuqi e nenit të ndryshuar | 190.0 | 190.0 | | |
| 1.(a).2 | Ndryshime të neneve 128/b dhe 110/a, të Kodit Penal, mbi trafikimin e personave, për të përfshirë në një nen të | MB<br>MD | 2018-2019 | Neni i shfuqizuar; | 190.0 | 190.0 | | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | vetëm trafikimin e të rriturve dhe të miturve, si dhe për të trajtuar qartë trafikimin e brendshëm të fëmijës | DPPSH<br>PP | | Hyrja në fuqi e nenit të ndryshuar | | | | |
| 1.(a).3 | Ndryshimi i nenit 114 (2) të Kodit Penal në lidhje me shfrytëzimin e të miturve për prostitucion, me qëllim harmonizimin me Konventën e KE-së | MB<br>MD<br>DPPSH<br>PP | 2018-2019 | Neni i ndryshuar;<br>Hyrja në fuqi e nenit të ndryshuar | 190.0 | 190.0 | | |
| 1.(a).4 | Ndryshimi i Kodit të Procedurës Penale për të përfshirë në kompetencën e SPAK të gjitha çështjet e TQNJ, si dhe për të garantuar kompensimin e viktimës | MB<br>MD<br>DPPSH<br>PP | 2018-2019 | Kodi i ndryshuar;<br>Hyrja në fuqi e Kodit, të ndryshuar<br>Numri i vendimeve për kompensim | 380.0 | 380.0 | | |
| 1.(a).5 | Ndryshimi i Kodit Penal dhe Procedural Penal për të pasqyruar dispozitat e Konventës së KE-së kundër Trafikimit të Organeve Njerëzore, të ratifikuar me ligjin nr. 150/2015, datë 21.12.2015 | MB<br>MD<br>DPPSH<br>PP | 2018-2019 | Kodi i ndryshuar;<br>Hyrja në fuqi e Kodit, të ndryshuar | 380.0 | 380.0 | | |
| 1.(a).6 | Ngritja e një grupi *ad-hoc* për kryerjen e një analize dhe vlerësimi të thelluar mbi nevojën për një ligj të vecantë me fokus mbrojtjen e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit. | MB<br>MD<br>PP<br>Qendrat e trajtimit të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit | 2018-2020 | Ngritja e grupit adhoc brenda vitit 2018<br>Vlerësimi brenda vitit 2019 | 445.680 | 445.680 | | |
| 1.(a).7 | Vazhdim i shkëmbimit të përvojave me agjencitë e huaja ligjzbatuese, nëpërmjet trajnimeve, vizitave studimore, pjesëmarrjes në projekte rajonale/ndërkombëtare etj. | DPPSH/MB, PP<br><br><br>donatorë | Në vazhdimësi | Numri i personave që kanë përfituar nga trajnimet, seminaret, takimet, vizitat studimore dhe veprimtaritë rajonale/ndërkombëtare. | 1,386.0 | 462.0 | | 924.0 |
| 1.(a)8 | Forcimi i bashkëpunimit në hetimet financiare antitrafikim mes Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, PP dhe Njësisë për Krimet Ekonomike në PSH, nëpërmjet kryerjes së hetimeve, operacioneve dhe trajnimeve të përbashkëta.<br>Dhënia e kontributit të SHISH në informimin paraprak për veprat e trafikimit të personave, në funksion të hetimit të këtyre veprave. | MFE në bashkëpunim me PP, DPPSH/Drejtoria kundër Krimit Ekonomik<br>SHISH | Gjashtë mujori i parë vitit 2019 | Zbatimi i PSV-ve<br>Trajnimet e organizuara<br>Mbajtja e takimeve të rregullta | 2,552.7 | 2,552.7 | | |
| 1.(a).9 | Forcimi i bashkëpunimit mes Policisë së Shtetit, Inspektoratit Shtetëror të Punës (ISHP) dhe Departamentit të Tatimeve.<br>Rishikimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Koordinatorit Kombëtar, DPPSH, ISHP dhe përfshirja në të edhe të Drejtorisë së Përgjithshme të. | DPPSH, MFE/IShP,<br><br>Partnerë<br><br>DPT | 2018- 2020<br><br><br><br>2019 | Takime të rregullta<br>Trajnimet, personeli i trajnuar<br><br><br>Marrëveshja e rishikuar | 557.1 | 557.1 | | |

**OBJEKTIVI SPECIFIK 1.(b) Rritja e aftësive dhe kapaciteteve profesionale të aktorëve të zinxhirit të drejtësisë penale për të hetuar dhe dokumentuar të gjitha format e trafikimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.**

**TREGUESIT:** Nr. i regjistrimeve të çështjeve penale/hetimeve për trafikim të personave, nisur nga provat e siguruara nëpërmjet hetimeve proaktive; numri i dënimeve të mbështetura mbi prova proaktive

| Nr. | Veprimtari dhe nënveprimtari | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto (*në mijëra lekë*) | Burimi i financimit (*në mijëra lekë*) | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për fonde |
| 1.(b).1 | Përmirësimi i Rregullores së Policisë së Shtetit për ecurinë në karrierë për të bërë të mundur mbajtjen dhe motivimin e oficerëve të specializuar për cështjet antitrafik, si dhe ndryshime të përshkrimeve të punës. | DPPSH<br>Akademia e Sigurisë | 2018 | Miratimi i ndryshimeve të Rregullores | 111.42 | 111.42 | | |
| 1.(b).2 | Rritje e numrit të punonjësve të policisë gra dhe vajza të kualifikuara që do të punojnë në strukturat antitrafikim; Prania e psikologut/punonjësit social në çdo Drejtori Vendore të Policisë | DPPSH/DVP<br>Akademia e Sigurisë<br>PP | 2018 | Nr. i punonjëseve gra/vajza të specializuara, kryesisht në aspektin psiko-social, të cilat merren me kohë të plotë me TQNj në nivel qendror dhe atë rajonal | 3,757.8 | 3,757.8 | | |
| 1.(b).3 | Kryerja e trajnimeve të vazhdueshme për hetime pro-aktive për punonjësit e strukturave ligjzbatuese | PP<br>MB/ DPPSH<br>Akademia e Sigurisë<br>SHM | Në vazhdimësi | Nr. i punonjësve ligjzbatues të trajnuar profesionalisht për përdorimin e teknikave të hetimit të drejtuara nga informacioni | 813.6 | 813.6 | | |
| 1.(b).4 | Pajisja e strukturave policore antitrafikim me mjetet e nevojshme logjistike | PSH<br>Donatorë | Në vazhdimësi | Pajisjet e nevojshme janë në dispozicion | 1,750.0 | 1,750.0 | | |
| 1.(b).5 | Dhënia e udhëzimeve punonjësve të policisë Antitrafik dhe prokurorëve mbi dallimet mes TQNj dhe kontrabandimit, trafikimit për shfrytëzim për punë të detyruar, si dhe mes trafikimit të brendshëm dhe atij ndër- Kufitar nëpërmjet:<br>- Trajnimit të trajnerëve për punonjës të policisë të seksioneve të trafiqeve të paligjshme nga prokurorë të Prokurorë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë/PP;<br>- Trajnimit të punonjësve të policisë të seksioneve të trafiqeve të paligjshme nga punonjësit e trajnuar të PSH. | PP<br>DPPSH<br>SHM<br>ZKKA<br>MKR<br>OJF<br>OSBE<br>ON | Në vazhdimësi | Nxjerrja e urdhrave/udhëzimeve/letër porosive<br><br>Nr. i të trajnuarve të nivelit bazë | 2,950.0 | 2,950.0 | | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | - Trajnimeve për rritjen e aftësisë së punonjësve të policisë për kualifikimin ligjor të veprës penale të trafikimit të personave dhe dallimin me veprat e tjera të ngjashme[29]. | | | | | | | |
| 1.(b).6 | Trajnimi i gjithë punonjësve të strukturave ligjzbatuese, strukturave shtetërore dhe punonjësve të organizatave që punojnë me të rinj dhe fëmijë mbi ndryshimet ligjore, të përmendura në pikat 1 (a) 1,2,3,4,5, (si më lart), si dhe mbi njohjen e elementeve të veprës penale të trafikimit të personave, profilit të viktimës dhe tendencave të fenomenit. | DPPSH<br>PP<br>Shkolla e Magjistraturës<br>OSBE<br>MKR<br>OJF<br>partnerët | Në vazhdimësi | Ngritja e kapaciteteve të strukturave ligjzbatuese;<br>Numri/ % e punonjësve të trajnuar | 1,107.0 | | | 1,107.0 |
| 1.(b).7 | Trajnimi i punonjësve të patrullës së përgjithshme të policisë, të repartit "Shqiponja" dhe SPZ-ve mbi identifikimin, hetimin, mbledhjen e informacionit për çështjet e trafikimit dhe bashkëpunimi ndërsektorial | Akademia e Sigurisë, Organizatat që punojnë në çështjet antitrafikim dhe kanë ekspertizë ligjore | Në vazhdimësi | Numri dhe përqindja e punonjësve të policisë të cilët janë trajnuar për mbledhjen e informacionit të zbulimit të nivelit bazë në lidhje me rastet e trafikimit të personave (TiP) | 2,237.4 | 2,237.4 | | |

**OBJEKTIVI SPECIFIK 1.(c) Përmirësimi i bashkëpunimit, bashkërendimit dhe shkëmbimit të informacionit institucional dhe ndër-sektorial në drejtësinë penale**

**TREGUESIT:** % e çështjeve penale që përfundojnë në ndjekje penale

| Nr. | Veprimtari dhe nënveprimtari | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto *(në mijëra lekë)* | Burimi i financimit *(në mijëra lekë)* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për fonde |
| 1.(c).1 | Forcimi i bashkëpunimit mes Policisë së Shtetit, Inspektoratit Shtetëror të Punës (IShP) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nëpërmjet zbatimit të inspektimeve të përbashkëta. | DPPSH<br>Ministria e Financave dhe Ekonomisë/Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve<br>ISHP<br>OSBE | Në vazhdimësi | Nr. i takimeve dhe inspektimeve të përbashkëta të organizuara | 3,150.0 | 3,150.0 | | |
| 1.(c.).2 | Shkëmbimi i informacionit me ASHMDF në nivel kombëtar nga strukturat përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi;<br>Rritja e nivelit të monitorimit të ASHMDF-së dhe strukturave të tjera në nivel vendor, për mënyrën e identifikimit dhe menaxhimit të rasteve të fëmijëve të marrë në mbrojtje, sidomos me fokus tek VMT dhe VT | ASHMDF<br>NJMF/Shërbimet sociale në bashki<br>DVP<br>DAR<br>DSHP | Çdo vit | Të dhënat statistikore<br>Shkëmbim informacioni | 22.824 | 22.824 | | |
| 1.(c).3 | Përmirësimi i identifikimit të hershëm të fëmijëve viktima të | ASHMDF | Në | Numri i rasteve | 1,114.2 | 1,114.2 | | |

[29] Me ndryshimet e KPP, referimet do bëhen edhe në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë

| Nr. | Veprimtari dhe nënveprimtari | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto *(në mijëra lekë)* | Burimi i financimit *(në mijëra lekë)* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për fonde |
| | mundshme të trafikimit dhe referimi i tyre tek shërbimet e përshtatshme lokale apo qendrore për mbrojtje dhe rehabilitim të menjëhershëm; | NJMF<br>SHSSH<br>DVP<br>DAR<br>DSHSB<br>Qendra ditore/ rezidenciale jo publike | vazhdimësi | Monitorimi | | | | |
| 1.(c).4 | Zhvillimi i takimeve çdo 3 muaj me Prokurorët e Prokurorisë për Krime të Rënda/Rretheve në funksion të procedimeve penale në ndjekje | DPPSh<br>PP<br>MKR | Në vazhdimësi | Numri i takimeve | 857.1 | 857.1 | | |
| 1.(c).5 | Zbatimi i MM mes PSH, PP dhe KK për krijimin e Task Forcës për Analizën e Integruar të Çështjeve të Mbyllura të Trafikimit të Personave;<br>Kryerja e analizës së integruar të çështjeve të mbyllura të trafikimit të personave. | DPPSH<br>PP<br>ZKKA<br>TASK-FORCA<br>PAMECA<br>ICITAP | Në vazhdimësi | Nr. i çështjeve të shqyrtuara; Përgatitja e raporteve vjetore dhe nxjerrja e rekomandimeve<br>TF, Grupi Këshillimor i TF. | 501.39 | 501.39 | | |
| 1.(c).6 | Krijimi i një sistemi të unifikuar të dhënash mbi çështje penale të trafikimit (për të ndjekur të gjitha çështjet penale që nga ndjekja penale, shpallja fajtor dhe dhënia e dënimit, i cili të përdoret bashkërisht nga prokuroria dhe policia (kjo e fundit do të ketë akses të kufizuar) | MD<br>PP<br>DPPSH | Në vazhdimësi | Numri i të dhënave | 5,550.0 | 5,550.0 | | |
| 1.(c).7 | Miratimi i Procedurave të reja Standarde të Veprimit (PSV) për mbrojtjen e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit | MB<br>ZKKA | 2018 | Miratimi i aktit | 190.0 | 190.0 | | |
| 1.(c).8 | Prezantimi i Procedurave të reja Standarde të Veprimit (PSV) për mbrojtjen e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit.<br>Krijimi i një platforme online për trajnimin e vazhduar të profesionistëve mbi çështje të trafikimit të personave | ZKKA<br>MKR<br>OJF<br>Partnerët | 2018-2020 | Zbatimi i PSV-ve<br>Mbajtja e takimeve për prezantimin e dokumentit<br><br>12 trajnime të organizuara me nga 30 persona/trajnimi<br>150 profesionistë të trajnuar | 540.0 | 540.0 | | |

**OBJEKTIVI SPECIFIK 1.(d): Forcimi i mekanizmave për mbrojtjen e viktimave në të gjithë zinxhirin e drejtësisë penale (qasja, aksesi në drejtësi).**
**TREGUESIT:** Nr. i VT të përfshira në Programin e Posaçëm për Mbrojtjen e Dëshmitarëve; Nr. i çështjeve të trafikimit të personave ku përdoren pajisje për mbrojtjen e viktimave/dëshmitarëve

| Nr. | Veprimtari dhe nënveprimtari | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto *(në mijëra lekë)* | Burimi i financimit *(në mijëra lekë)* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për fonde |
| 1.(d).1 | Hartimi i udhëzimeve për intervistimin e VT/VMT | ZKKA<br>DPPSH, PKR, Partnerët | 2018-2019 | Projekt-udhëzimet në dispozicion | 74.280 | 74.280 | | |
| 1.(d).2 | Sigurimi i infrastrukturës për viktimat/dëshmitarët që të kenë akses në mbrojtje | PP<br>DPPSH<br>GjKR<br>AP | Në vazhdimësi | Pika kontakti për viktimat apo dëshmitarët, për tu siguruar që të jenë marrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtje;<br>Nr. i kopjeve të materialeve informuese mbi të drejtat e viktimave në një proces penal, të cilat u janë shpërndarë VT/VMT | 613.8 | 613.8 | | |
| 1.(d).3 | Lehtësimi i komunikimit me Prokurorinë/Prokurorët e Çështjeve nëpërmjet pikës së kontaktit të Prokurorisë në MKR ose AP | PP<br>MKR<br>AP<br>Qendrat e VT | Në vazhdimësi | Caktimi i pikës së kontaktit të MKR-së<br>Informimi i AP-së mbi ecurinë e çështjes<br>Numri i rasteve të referuara | 1,337.04 | 1,337.04 | | |
| 1.(d).4 | Sigurimi dhe mbrojtja e dëshmitarëve në të gjithë zinxhirin e drejtësisë (gjykata, PP dhe Polici (nëpërmjet udhëzimeve, pajisjeve për lidhje nëpërmjet mjeteve autovizive, zonave të veçanta për pritje përpara seancave etj.) | PP<br>GJKR<br>DPPSH<br>MD | Në vazhdimësi | Udhëzimet dhe Nr. i prokurorëve dhe gjyqtarëve që kanë njohuri mbi përmbajtjen e udhëzuesve dhe mbi nevojat për mbrojtje që kanë VT/VMT-të | 610.02 | 610.02 | | |
| 1.(d).5 | Mbrojtja dhe përfaqësimi i VT me avokat dhe psikolog falas | MD | Në | Nr. i VT të përfaqësuara me | 2,100.15 | 2,100.15 | | |

| Nr. | Veprimtari dhe nënveprimtari | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto *(në mijëra lekë)* | Burimi i financimit *(në mijëra lekë)* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për fonde |
| | në të gjitha fazat e procesit, që nga referimi i çështjes në Prokurori, deri në dhënien e vendimit të formës së prerë, përfshirë edhe ekzekutimin në rast të vendimit për kompensim | MB<br>PP<br>Gjykatat<br>Dhoma Komb. e Av.<br>Qendrat e VT | vazhdimësi | avokat dhe psikolog falas | | | | |
| 1.(d).6 | Ngritja dhe zbatimi i Skemës Shtetërore të Kompensimit të VT dhe financimit të shërbimeve të rehabilitimit të tyre, duke përdorur si pasuritë e sekuestruara, ashtu edhe fonde shtetërore, si dhe publikimi i procedurave për akses në të. | MFE<br>DPPSH<br>PP<br>ZKKA | Në vazhdimësi | Nr. i VT të cilat kanë marrë kompensim nëpërmjet kësaj skeme dhe nr. i qendrave pjesë e KKSAT kanë marrë financim për shërbime rehabilitimi | 9,000.0 | | | 9,000.0 |
| 1.(d).7 | Lehtësimi i procedurave të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në favor të viktimave të trafikimit, në mënyrë që të garantohet procedura e ekzekutimit të përbarimit. | Zyrat e Pëmbarimit<br>PP<br>ZKKA | Në vazhdimësi | Nr. i vendimeve gjyqësore të ekzekutuara | 535.2 | 535.2 | | |
| 1.(d).8 | Hartimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit 10192 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar, në mënyrë që të ardhurat e përfituara nga zbatimi i këtij ligji të përdoren për dëmshpërblimin e viktimave të trafikimit në masën e vendosur me vendim gjyqësor. | MB<br>MFE<br>AAPK<br>OSBE | 2019 | Aktet nënligjore të miratuara | 570.0 | 570.0 | | |

**OBJEKTIVI SPECIFIK 1.(e): Përmirësimi i bashkëpunimit dypalësh, rajonal dhe ndërkombëtar i strukturave ligjzbatuese në luftën kundër trafikimit të personave.**

**TREGUESIT:** Numri i ekstradimeve; numri i kërkesave të suksesshme/pasuksesshme për ndihmë të ndërsjellë ligjore; numri i protokolleve të rinj për bashkëpunim policor; numri i operacioneve të përbashkëta; numri i arrestimeve dhe ndjekjeve penale të trafikantëve, që vijnë si rezultat i bashkëpunimit ndërkufitar apo ndërkombëtar.

| Nr. | Veprimtari dhe nënveprimtari | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto *(në mijëra lekë)* | Burimi i financimit *(në mijëra lekë)* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për fonde |
| 1.(e).1 | Përfundimi dhe/ose zbatimi i Marrëveshjeve/Protokolleve për shkëmbimin e të dhënave dhe hetime të përbashkëta me Malin e Zi, Greqinë, Kosovën, Maqedoninë dhe Serbinë, Italinë, Mbretërinë e Bashkuar dhe vende të tjera të BE-së sipas nevojave, si dhe takime e aktivitete të përbashkëta, të rregullta.<br><br>Përgatitja e udhëzuesve dhe moduleve të trajnimit për zbatimin e Protokolleve bilaterale me Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë. | MB/DPPSH,<br>MEPJ<br>Terre des Hommes | Në vazhdimësi<br><br>2018-2020 | Marrëveshjet/Protokollet e firmosura Raportet e monitorimit<br><br>Udhëzues dhe modul trajnimi i prodhuar që zbërthen protokollet bilaterale të bashkëpunimit me Kosovën, Malin e Zi dhe Maqedoninë | 1,487.850 | | | 1,487.850 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.(e).2. | Forcimi i bashkëpunimit dypalësh dhe ndërkombëtar në fushën e zbatimit të ligjit kundër trafikimit të personave (parandalimi i TiP, identifikimi, referimi dhe mbrojtja e ndjekja penale ndër-shtetërore e viktimave) dhe sidomos bashkëpunimi për kategori të ndryshme fëmijësh të shoqëruar apo të pashoqëruar (VMT, VT, fëmijë në rrezik të madh, fëmijë migrantë me dokumente të rreme apo pa dokumente).<br><br>Plane veprimi të përbashkëta midis Shqipërise dhe vendeve të rajonit (kufitare) për zbatimin e protokolleve bilaterale për identifikimin, njoftimin, referimin dhe kthimin e asistuar të VT/VMT. | DPPSH/Strukturat përgjegjëse:<br>-Departamenti për Kufirin dhe Migracionin<br>-Departamenti për Sigurinë Publike<br>-Departamenti i H.K.O.K.R J<br>MPEJ<br>DRSHSSH<br>PMF<br>OJF shqiptare dhe aktorë të tjerë partnerë, shtetërorë dhe joshtetërorë, në vendet e destinacionit<br><br>Terre des Hommes | Në vazhdimësi<br><br>2018-2020 | Numri i takimeve të përbashkëta<br>Ekzistenca e listës së kontaktit<br>Ekzistenca e ndjekjeve penale ndër-shtetërore, dhe e standardeve dhe PSV-ve për identifikimin, referimin dhe mbrojtjen/ndihmën e VMT dhe VT-ve<br><br>Plane veprimi të përbashkëta midis Shqipërisë dhe vendeve kufitare përsa i përket bashkëpunimit në luftën kundër TQNJ | 12,066.0 | 12,066.0 | | |

## 2. SYNIMI STRATEGJIK:
## Synimi Strategjik 2: Forcimi i integritetit të punonjësve të zbatimit të ligjit në veprat penale të trafikimit të personave dhe lufta kundër korrupsionit në radhët e tyre.

**OBJEKTIVI SPECIFIK (2.a) Monitorimi i përfshirjes së punonjësve të strukturave ligjzbatuese në veprat e trafikimit të personave.**
**TREGUESIT:** Nr. i informacioneve konfidenciale (nëpërmjet telefonit etj.) për përfshirje të punonjësve në trafikim, të cilat janë regjistruar në polici.
Nr. i masave të marra bazuar në informacion konfidencial të marrë nga publiku.

| Nr. | Veprimtari dhe nënveprimtari | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto *(në mijëra lekë)* | Burimi i financimit *(në mijëra lekë)* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për fonde |
| 2.(a).1 | Promovimi i Linjës Kombëtare 116006 dhe Aplikacionit Raporto! Shpëto! për raportim nga publiku kundër trafikimit të personave<br>Promovimi i shërbimeve të emergjencës për të mitur: Aplikacioni Unë mbroj fëmijët #une mbroj fëmijët<br>Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë – Alo 116 111 | MB<br>PSH<br>ZKKA<br>ASHMDF<br>Terre des Hommes<br>partnerët | Në vazhdimësi | Nr. i veprimtarive promovuese të organizuara;<br>Nr. i rasteve të identifikuarar nëpërmjet Linjave Kombëtare dhe Aplikacioneve;<br>1 spot ndërgjegjësues në radio & televizion për TQNJ (përfshirë promovimin e 116 006); 1 fushatë informuese/ndërgjegjësuese për TQNJ në media sociale. | 318.0 | 318.0 | | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.(a).2 | Informimi i publikut mbi masat e marra anti- Korrupsion, si dhe rezultatet e tyre<br>Promovimi i numrit 08009090 | MB<br>PSH<br>SHÇBA | Në vazhdimësi | Statistika të publikuara mbi ndjekjet penale të nëpunësve shtetërorë të korruptuar<br>Numri i rasteve të raportuara tek linja 08009090 | 6,030.0 | 6,030.0 | | |
| 2.(a).3 | Sigurimi i ndjekjes penale dhe dënimi i të gjithë oficerëve të policisë, gjyqtarëve, prokurorëve dhe zyrtarëve të tjerë publikë, të cilët janë pjesëmarrës ose ndërmjetësojnë në trafikimin e personave | SHÇBA/ MB, MD-ja në bashkëpunim me PP-në | Në vazhdimësi | Numri i oficerëve të policisë, prokurorëve dhe zyrtarëve të tjerë publikë në ndjekje penale dhe të dënuar | 2,307.0 | 2,307.0 | | |
| 2.(a).4 | Forcimi i Drejtorisë së Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave për të përmirësuar hetimet e përfshirjes së nëpunësve të strukturave ligjzbatuese në trafikimin e personave. | MB<br>SHÇBA<br>SHISH | Në vazhdimësi | Numri i hetimeve të suksesshme në lidhje me trafikimin e personave, të kryera nga kjo drejtori. | 3,460.5 | 3,460.5 | | |
| 2.(a).5 | Ndërtimi/forcimi i besimit të publikut tek forcat e zbatimit të ligjit dhe vazhdimi i nxitjes së denoncimit të zyrtarëve të korruptuar | MB,<br>DPPSH | Në vazhdimësi | Numri i çështjeve të hapura mbi bazën e informimit nga publiku | 2,307.0 | 2,307.0 | | |

## MBROJTJA

**1. SYNIMI STRATEGJIK: Sigurimi i identifikimit fillestar dhe referimeve për mbrojtje të fëmijëve dhe të rriturve si viktima/viktima të mundshme trafikimi për qëllime shfrytëzimi, dhe referimi i menjëhershëm i tyre pranë shërbimeve të duhura të asistencës, bazuar në nevojat individuale në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit (PSV-të)**
**Treguesit:** Numri i përgjithshëm i identifikimeve; identifikimi i personave të trafikuar brenda vendit, personave të trafikuar për qëllime shfrytëzimi për punë, si dhe numri i viktimave fëmijë në veçanti; përmbajtja e protokolleve të çështjes në përputhje me PSV-të

**OBJEKTIVI SPECIFIK: 1. (a): Garantimi në vazhdimësi i funksionimit efikas të Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe shtrirja e tij në nivel qarku, bashkie (nëpërmjet grupeve vendore të koordinimit për marrjen e masave parandaluese dhe identifikimin e personave të trafikuar) në përputhje me standardet dhe PSV-të**

| Nr. | Veprimtari dhe nënveprimtari | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto *(në mijëra lekë)* | Burimi i financimit *(në mijëra lekë)* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për fonde |
| 1.(a).1 | Forcimi i kapacitetit të Autoritetit Përgjegjës (AP) për të përmbushur funksionin e tij, kryesisht për të bashkërenduar dhe kontrolluar zbatimin e marrëveshjes së MKR dhe PSV për identifikimin, referimin për asistencë dhe riintegrimin e viktimave, menaxhimin e informacionit dhe raportimin mbi VMT dhe VT (duke mirëmbajtur bazën e të dhënave në lidhje me rastet e referimit të VMT dhe VT): | ZKKA<br>MKR<br>AP | Në vazhdimësi | Një nëpunës i ZKKA me kohë të plotë është i ngarkuar për të asistuar AP<br><br>Përshkrimet e punës për pikat e kontaktit të AP, përfshirë detyrat në lidhje me AP si pjesë e detyrave | 2,196.0 | 2,196.0 | | |

| Nr. | Veprimtari dhe nënveprimtari | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto *(në mijëra lekë* | Burimi i financimit *(në mijëra lekë)* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për fonde |
| | - Ekzistenca e një nëpunësi me kohë të plotë tek ZKKA si Sekretariat i AP-së;<br>- Përcaktimi si detyra funksionale në përshkrimet e tyre të punës i detyrave të anëtarëve të AP-së. | | | funksionale. | | | | |
| 1.(a).2 | Përmirësimi i bazës së të dhënave për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit për regjistrimin, ndjekjen dhe monitorimin e rasteve, si dhe raportimin pranë AP/ZKKA:<br>- Caktimi i një nëpunësi me kohë të plotë dhe garantimi i mbështetjes teknike për hedhjen dhe mirëmbajtjen e të dhënave.<br>- Garantimi i raportimit të rregullt nga AP/ZKKA sipas formateve të miratuara. | ZKKA, AP, IT/DPPSH | Në vazhdimësi | Funksionim i plotë i Bazës së të Dhënave mbi Viktimat<br>Një nëpunës me kohë të plotë i caktuar në ZKKA<br>Paraqitje e rregullt e të dhënave nga të gjithë aktorët kryesorë sipas modaliteteve dhe formatit raportues të miratuar<br>Raporte (tremujore) të rregullta nxirren nga AP | 2,415.6 | 2,415.6 | | |
| 1.(a).3 | Organizimi i takimeve të rregullta të anëtarëve të MKR-së | ZKKA<br>MKR | Në vazhdimësi | Numri i takimeve dhe minutat e takimeve të MKR | 668.52 | 668.52 | | |
| 1.(a).4 | Rishikimi i Marrëveshjes së MKR-së, bazuar në ndryshimet strukturore qeveritare dhe shtimi me anëtarë të tjerë | ZKKA<br>MKR<br>Exspertë të fushës | 2018-2019 | Krijimi i Grupit të Punës për rishikimin.<br>Organizimi i takimeve<br>Marrëveshja e firmosur | 67.14 | 67.14 | | |
| 1.(a).5 | Rishikimi i Udhëzimit të AP-së<br>Përfshirja në AP e një përfaqësuesi nga ASHMDF | ZKKA, AP<br>Exspertë të fushës | 2018 | Krijimi i Grupit të Punës për rishikimin.<br>Organizimi i takimeve Udhëzimi i rishikuar | 57.14 | 57.14 | | |
| 1.(a).6 | Krijimi i Bordit Këshillimor të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit | ZKKA,<br>KKSAT | 2018 | Termat e referencës<br>Plani i Punës | 720.0 | | | 720.0 |

**OBJEKTIV SPECIFIK: 1. (b) Forcimi i kapaciteteve të të gjitha strukturave/aktorëve të përfshirë në parandalimin, identifikimin, referimin dhe asistencën ndaj VMT/VT, në përputhje me PSV-të**

**TREGUESIT:** Numri i personave të identifikuar dhe referuar, zbatimi me rigorozitet i PSV-ve, numri dhe përqindja e aktorëve përkatës që njohin treguesit e trafikimit të personave dhe roli i tyre në parandalimin/trajtimin e fenomenit të trafikimit të personave.

| Nr. | Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto *(në mijëra lekë)* | Burimi i financimit *(në mijëra lekë)* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për fonde |
| 1.(b).1 | Trajnime për ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e standardeve për trajtimin e VT/VMT në qendrat pritëse dhe riintegruese dhe mbi PSV-të, dhe konkretisht hapat specifike për fëmijët (identifikimi, referimi, menaxhimi i rasteve të të miturve të identifikuar VMT/VT, ofrimi (riintegrimi) i asistencës dhe monitorimi i procesit të riintegrimit) | ZKKA, AP dhe MKR, ASHMDF<br>SHSSH<br>NJMF<br>OJF/ON dhe partnerët | Në vazhdimësi | Numri dhe përqindja e aktorëve përkatës të trajnuar, numri dhe përqindja e njohësve të PSV-ve dhe të standardeve të shërbimit | 1,220.4 | | | 1,220.4 |
| 1.(b).2 | Trajnimi i anëtarëve të AP-së dhe i anëtarëve të Task Forcës së MKR-së, si dhe aktorëve antitrafik në nivel qendror dhe lokal;<br>Hartimi i një programi trajnimesh sektoriale dhe ndërsektoriale të vazhdueshme mbi PSV-të në të 12 qarqet; shpërndarja e kopjeve të PSV-ve të reja (sipas sektorëve)<br>Organizimi i trajnimeve të trajnerëve (ToT) me anëtarë të KRAT dhe Tryezave Teknike | ZKKA<br>MKR<br>KRAT<br>AP<br>Shkolla e Magjistraturës,<br>Akademia e Sigurisë,<br>ASHMDF,<br>SHSSH<br>Fakulteteti i Shkencave Sociale,<br>OJF,<br>ON | Në vazhdimësi<br>2018<br>Në vazhdimësi | Ekzistenca e moduleve të trajnimit të hartuara sipas aktorëve individualë dhe planet vjetore të trajnimit<br>Numri i trajnerëve dhe të trjnuarve (sipas institucionit/organizatës)<br>PSV-të të shpërndara tek aktorët individualë; Përqindja e aktorëve përkatës që kanë një kopje të PSV-ve. | 813.6 | | | 813.6 |
| 1.(b).3 | Hartimi i manualeve për secilin sektor mbi përdorimin e PSV-ve të reja | MSHMS<br>SHSSH<br>MASR<br>MFE<br>PSH<br>ZKKA<br>ASHMDF<br>IOM | 2019 | Ekzistenca e manualeve dhe numri i manualeve të shpërndara;<br>Numri i punonjësve që janë njohur me to | 450.0 | | | 450.0 |
| 1.(b).4 | Shkëmbimi i eksperiencave midis ofruesve të shërbimeve në qarqe dhe bashkive të ndryshme | KRAT, ZKKA, MKR | 2018 -2020 | Takime të rregullta të grupeve/aktorëve vendorë në nivel rajonal | 5,637.624 | 5,637.624 | | |

**OBJEKTIV SPECIFIK: 1. (c) Rritja e numrit të identifikimeve fillestare dhe referimeve të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit për të gjitha format e shfrytëzimit brenda vendit, në kufi, jashtë vendit, bashkëpunimi me NJMF për referimin e ndërsjellë për rastet e fëmijëve në situatë rruge të identifikuar ose dyshuar si VTM, si dhe rritja e vetidentifikimit të viktimave**

**TREGUESIT:** % Numri i identifikimeve të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit sipas moshës/gjinisë/shtetësisë/llojit të shfrytëzimit/strukturës së identifikimit

| Nr. | Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto *(në mijëra lekë)* | Burimet e financimit *(në mijëra lekë)* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për fonde |
| 1.(c).1 | Identifikimi proaktiv i viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit në nivel vendor | ZKKA, PSH<br>KRAT, firmëtarët e MKR-së,<br>NJMF<br>Shërbimet sociale në bashki<br>ON , OJF-të bashkitë | Në vazhdimësi | Numri i rasteve të identifikuara nga njësitë e lëvizshme dhe nga grupet e koordinimit në nivel vendor | 18,000.0 | 18,000.0 | | |
| 1.(c).2 | Intensifikimi i punës në terren sipas modelit ekzistues të Njësive Lëvizëse nëpërmjet:<br>1.Garantimit të qëndrueshmërisë së Njësive Lëvizëse, nëpërmjet sigurimit të fondeve dhe zgjerimit të zonave të punës së Njësive Lëvizëse.<br>2. Ngritjes së Njësive të Lëvizshme në qarqet me numrin më të lartë të viktimave/viktimave të mundshme të identifikuara.<br>3. Përcaktimit të statusit, roleve dhe përgjegjësive të Njësive Lëvizëse (NjL), dhe koordinimi i tyre me AP dhe të gjitha palët e interesit, në veçanti me NJMF/PMF dhe Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Policinë e Shtetit.<br>4. Hartimit të standardeve të shërbimit të njësive lëvizëse në identifikimin dhe referimin e VMT dhe VT.<br>5. Trajnimit të Njësive Lëvizëse mbi identifikimin dhe referimin e rasteve të trafikimit, trajnimit dhe asistencës teknike për Njësitë e reja.<br>6. Transferimi i modelit dhe ekspertizës së NJL ekzistuese drejt NJL të reja.<br>7. Krijimit të një mjeti për vlerësimin e efikasitetit të Njësive të Lëvizëse dhe rishikimi i rregullt i tyre. | TF e MKR-së,<br>AP<br>Qendrat e VT dhe OJF me ekspertizë në punën në terren<br><br>ON | Deri në fund 2019 | Vijimësia e punës së NJL të reja<br>Qartësimi i statusit dhe rolit të NjL<br>Miratimi i Memorandumit të Mirëkuptimit midis PSH në nivelin rajonal dhe NjL<br>Prania e Termave të Referencës dhe standardeve të shërbimit për NjL, si dhe profilet/përshkrimet e punës për anëtarët e NjL<br>Vlerësimi i NjL sipas mjetit vlerësues të miratuar më parë<br><br>Rishikimi i parë brenda vitit nga miratimi i AT PKV<br><br>Sigurimi i financimit për vitet e ardhshme | 4,108.0 | 3,280.0 | | 828.0 |
| 1.(c).3 | Identifikimi fillestar i VT/VMT nga strukturat e | Bashkitë/DSHSB | Në vazhdimësi | Numri i identifikimeve | 8,155.944 | 8,155.944 | | |

| Nr. | Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto *(në mijëra lekë)* | Burimet e financimit *(në mijëra lekë)* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për fonde |
| | koordinimit në nivel vendor | /NJMF, PMF, SHSR, KRAT, SHSSH, AP, OJF, ON dhe partnerët | | nëpërmjet strukturave në bashki | | | | |
| 1.(c).4 | Këshillimi dhe informimi i qytetarëve shqiptarë jashtë vendit nga stafi konsullor shqiptar, si dhe ofrimi i asistencës konkrete për viktimat e mundshme të trafikimit.<br>Aktivitete të nevojshme:<br>1. Përfshirja e detyrave që dalin nga zbatimi i MKR në përshkrimet e punës së stafit konsullor<br>2. Hartimi i udhëzimeve për zbatimin e PSV-ve për identifikimin dhe referimin e VMT dhe VT jashtë vendit<br>3. Përfshirja e një moduli për rritjen e ndërgjegjësimit mbi antitrafikimin në programin mësimor të Akademisë Diplomatike dhe shpërndarja e udhëzimeve mbi PSV për identifikimin e viktimave për stafin konsullor<br>4. Garantimi i shpërndarjes së informacionit të përditësuar për shqiptarët jashtë vendit nëpërmjet stafit diplomatik<br>5. Mbajtja e kontakteve aktive me qytetarë shqiptarë, Shoqëritë Shqiptare dhe OJF-të, si dhe aktorë të tjerë në kontakt me shqiptarët dhe VMT në vendet e destinacionit | MPEJ, ZKKA, PSH, OJF-të, ON dhe partnerët ndërkombëtarë<br><br>MPEJ<br><br>MPEJ<br><br>MPEJ/Akademia Diplomatike<br><br>MPEJ/Stafi Konsullor | Në vazhdimësi<br><br>Në vazhdimësi | Përshkrimet e punës të stafit diplomatik përmbajnë funksionet e tyre në zbatimin e MKR në përputhje me PSV-të<br>Numri i trajnimeve dhe pjesëmarrësve.<br>Prania e udhëzimeve për zbatim Organizimi i trajnimeve të rregullta për stafin diplomatik dhe shpërndarja e udhëzimeve.<br>Numri dhe përqindja e stafit diplomatik që ka njohuri mbi TiP dhe rolet e tyre, sipas MKR dhe PSV-ve, dhe numri i stafit që ka marrë udhëzime;<br><br>Programi Mësimor i Akademisë Diplomatike përfshin module mbi antitrafikimin | 224.280 | 74.280 | | 150.0 |
| 1.(c).5 | Negocimi/zbatimi i marrëveshjeve të veçanta për bashkëpunimin ndërkufitar në lidhje me fëmijët (fëmijë migrantë, fëmijë të pashoqëruar, viktima të mundshme të trafikimit dhe viktima të trafikimit) | MB<br>ZKKA<br>MKR<br>AP<br>partnerët | Në vazhdimësi | Numri i marrëveshjeve të negociuara<br>Procedura specifike mbi trajtimin e fëmijëve në lëvizje | 1,337.040 | 1,337.040 | | |
| | | | | | | | | |
| 1.(c).6 | Rritja e ndërgjegjësimit të inspektorëve të punës mbi identifikimin fillestar lidhur me trafikimin e personave për qëllime shfrytëzimi për punë<br><br>Organizimi i seancave të informimit për punëmarrësit dhe punëdhënësit në lidhje me identifikimin dhe referimin e | Inspektorati Shtetëror i Punës<br>ON<br>OSBE | Në vazhdimësi | Seminaret/takimet e organizuara, numri i pjesëmarrësve<br>Numri dhe përqindja e inspektorëve të punës të cilët kanë njohuri mbi TiP | 900.0 | 450.0 | | 450.0 |

| Nr. | Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto *(në mijëra lekë)* | Burimet e financimit *(në mijëra lekë)* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për fonde |
| | VMT, në degët rajonale, në bashkëpunim me ISHPSHSH Qendër | | | dhe që kanë në rolin e tyre parandalimin dhe identifikimin e VMT<br>Numri i rasteve të identifikuara nga inspektorët e punës | | | | |
| 1.(c).7 | Organizimi i trajnimeve për inspektorët e punës të degëve qendrore dhe rajonale lidhur me identifikimin fillestar të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit | ISHPSHSH<br>NJMF/PMF<br>OJF<br>partnerët | Në vazhdimësi | 120 inspektorë pune të trajnuar;<br>6 trajnime me nga 20 inspektorë në çdo seancë | 813.6 | | | 813.6 |
| 1.(c).8 | Përmirësimi i bashkëpunimit midis ISHP-së dhe Policisë së Shtetit për të rritur identifikimin e rasteve të trafikimit për qëllime të shfrytëzimit për punë, nëpërmjet:<br>1. Zbatimit me rigorozitet të Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Policisë dhe ISHPSHSH për krijimin e ekipeve të përbashkëta<br>2. Kryerjes së operacioneve të përbashkëta, bazuar në një plan operacional të përbashkët në përputhje me Marrëveshjen. | PSH, ZKKA, ISHP<br>Partnerët | Në vazhdimësi | Organizimi në mënyrë periodike i inspektimeve të përbashkëta mes ISHP dhe PSH<br>Numri i rasteve të identifikuara në lidhje me shfrytëzimin për punë, si rrjedhojë e inspektimeve të përbashkëta | 1,640.320 | 1,640.320 | | |
| 1.(c).9 | Përmirësimi i identifikimit të VMT dhe VT të huaj nga emigrantët e parregullt në territorin/në transit përmes territorit të Shqipërisë, nëpërmjet trajnimeve për Policinë e Kufirit & Migracionit mbi kontrollin e emigrantëve të parregullt, në përputhje me PSV-të;<br>Rritja e identifikimit të VMT në kufi, në veçanti fëmijët e pashoqëruar;<br>Rritja e nr. të rasteve të referuara pasi janë identifikuar nga NJMF e zonave kufitare përkundrejt NJMF - ve të zonave nga vijnë fëmijët<br>Rritja e rolit monitorues të ASHMDF-së për rastet e identifikuara dhe të referuara të fëmijëve VMT/VT | MB/Departamenti për Kufirin dhe Migracionin/DVP, ASHMDF<br>NJMF (në zonat kufitare)<br>DRSHSSH<br>ZKKA me partnerët | Në vazhdimësi | Trajnimi i punonjësve të Policisë Kufitare dhe Migracionit, si dhe punonjësve të SHSSHR dhe NJMF mbi TiP, përmban module mbi kontrollin e emigrantëve të parregullt;<br>Numri dhe përqindja e policëve të migracionit që njohin ndryshimin mes kontrabandimit dhe trafikimit<br>Numri dhe % e punonjësve të SHSSH dhe NJMF të trajnuar<br>Numri i identifikuar i VMT dhe VT të huaja | 610.2 | 610.2 | | |
| 1.(c).10 | Hartimi i një Udhëzuesi për identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e VMT, në kufi, bazuar në legjislacionin në fuqi | MB/Departamenti për Kufirin dhe | | Udhëzuesi i firmosur | 150.0 | 150.0 | | |

| Nr. | Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto *(në mijëra lekë)* | Burimet e financimit *(në mijëra lekë)* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për fonde |
| | | Migracionin/PSH, NJMF ZKKA me partnerët TdH | | | | | | |
| 1.(c).11 | Organizimi i trajnimeve të vazhdueshme për policinë e kufirit & migracionit mbi:<br>- Të gjitha format aktuale dhe të reja të trafikimit të personave<br>- Rolin e policisë kufitare dhe veprimet e marra në lidhje me parandalimin dhe identifikimin e VMT dhe VT, në përputhje me PSV-të<br>- Teknika intervistimi sensitive, bazuar në PSV | Departamenti për Kufirin dhe Migracionin/PSH ZKKA<br><br>MB/Akademia e Sigurisë<br>Terre des Hommes | 2018 e në vazhdim | Numri i punonjësve të kufirit të trajnuar, Numri dhe përqindja e punonjësve të policisë kufitare që kanë njohuri mbi trafikimin, ndryshimin midis kontrabandimit dhe trafikimit, si dhe numri dhe përqindja e punonjësve të policisë kufitare që mund të përshkruajnë rolin e tyre në parandalim, dhe PSV-të për identifikimin e hershëm të VT/VMT<br>Numri i punonjësve të policisë kufitare që ka njohuri mbi PSV-të specifike për fëmijët | 813.6 | 813.6 | | |
| 1.(c).12 | Sigurimi i pranisë së një punonjësi policie grua/vajzë dhe një punonjësi social femër, gjatë identifikimit të VMT/VT (të rritur dhe fëmijë) në PKK | DPPSH/Departament i për Kufirin dhe Migracionin/PSH | 2018 e në vazhdim | Numri i PKK-ve me prani të përhershme të punonjëses së policisë dhe një punonjëseje sociale femër | 519.960 | 519.960 | | |
| 1.(c).13 | Garantimi i vendeve të përshtatshme për fëmijë për kryerjen e intervistës fillestare dhe zyrtare dhe për pritjen për referim.<br>Garantimi i PMF dhe psikologut në rastet e intervistimit të fëmijëve;<br>Garantimi që intervsitimi i të miturit të kryhet në kushte optimale, mundësisht vetëm një herë (materiale regjistrimi, audio vizive) për të shmangur intervistimin nga çdo person që vihet në kontakt me fëmijën. Garantimi i shërbimit të emergjencës 72 orëshe për të miturin. | Departamenti për Kufirin dhe Migracionin/PSH NJMF/PMF, SHSSH<br>Partnerët | Në vazhdimësi | 12 Dhoma të përshtatshme për intervistimin/pritjen e fëmijëve<br>deri në fund të 2020<br>Prania e PMF në intervistë | 1,750.0 | | | 1,750.0 |
| 1.(c).14 | Parandalimi/identifikimi i trafikimit të të miturve në kufi/kalimi i paligjshëm i kufirit nga fëmijët, vetëm ose të | DPPSH/Departament i për Kufirin dhe | Në vazhdimësi | Stafi në çdo PKK regjistron rregullisht çdo fëmijë – të | 1,403.892 | 1,403.892 | | |

| Nr. | Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto (*në mijëra lekë*) | Burimet e financimit (*në mijëra lekë*) | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për fonde |
| | shoqëruar me të rritur nëpërmjet:<br>1. Kontrollit të detyrueshëm të dokumentacionit për fëmijët<br>2. Regjistrimi në PKK e çdo fëmije që hyn ose del nga Shqipëria, i shoqëruar ose jo, në përputhje me TIMS, në bazën e të dhënave SIVET dhe në përputhje me PSV-të specifike për fëmijët. | Migracionin<br><br>AP, SHSSH | | shoqëruar ose jo, që hyn ose del nga Shqipëria.<br>Numri i fëmijëve i regjistruar sipas kategorisë, numri i fëmijëve të identifikuar në PKK si VMT/VT<br>Çdo fëmijë që hyn ose del nga Shqipëria, i shoqëruar ose jo, kontrollohet rregullisht dhe regjistrohet në bazat e të dhënave përkatëse. | | | | |
| 1.(c).15 | Rritja e vetidentifikimit të VMT dhe VT | | Në vazhdimësi | Numri dhe përqindja e vetidentifikimeve | 55.71 | 55.71 | | |

**OBJEKTIV SPECIFIK: 2. (a) Garantimi dhe qëndrueshmëria e ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe të përshtatshme për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit (fëmijë dhe të rritur në qendra ose jashtë, përfshirë asistencë sociale, mjekësore, psikologjike dhe ligjore, si dhe garantimi i respektimit të standardeve kombëtare të përcaktuara dhe PSV-ve**

**TREGUESIT:** Numri i VMT dhe VT që marrin asistencë; lloji i asistencës (mjekësore, ligjore, mbrojtje fizike); numri i personave të trafikuar që marrin asistencë sipas nevojave individuale nëpërmjet strehëzave ose direkt në komunitet, numri/përqindja e personave që marrin asistencë në komunitet, përmbajtja e dosjeve të rasteve; vlerësimi i shërbimeve sipas personave të trafikuar të pyetur; garantimi i financimit afatgjatë i qendrave/mbështetjes në komunitet për personat e trafikuar

| Nr. | Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto (*në mijëra lekë*) | Burimet e financimit (*në mijëra lekë*) | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për fonde |
| 2.(a).1 | Hartimi dhe zbatimi i standardeve të riintegrimit; Skemat e asistencës, mbrojtjes dhe skemat e përfitimit të shërbimit shëndetësor si kontigjent, sigurimet shoqërore të VT jashtë qendrave /kush refuzon të shkojë në strehë (duke u përqendruar veçanërisht mbi trafikimin e brendshëm dhe rastet e shfrytëzimit për punë të detyruar) | ZKKA, MKR, MSHMS, NJMF, SHSSH, IOM, KKSAT, ofrues të tjerë shërbimesh (shtetërorë ose jo), ON | Deri në fund të 2018 | Prania e standardeve për asistencën dhe mbrojtjen në komunitet; skema konkrete asistence; Numri i VMT dhe VT që përfitojnë nga këto | 150.0 | | | 150.0 |

| Nr. | Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto *(në mijëra lekë)* | Burimet e financimit *(në mijëra lekë)* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për fonde |
| 2.(a).2 | Garantimi i funksionimit afatmesëm dhe afatgjatë i strehëzave dhe ofruesve të shërbimeve publike dhe jopublike sipas standardeve të miratuara të shërbimit | MKR, MSHMS, SHSSH, ZKKA, KKSAT, me partnerët ndërkombëtar | Në vazhdimësi | Zhvillimi i nevojave për burime dhe plan mobilizimi për kosto për funksionim të vazhdueshëm të qendrave. Sigurimi i financimit më afatgjatë nga kosto shtetërore | 185,190.0 | 185,190.0 | | |
| 2.(a).3 | Mbështetje financiare për vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve për VT /VMT nga strehëzat, anëtare të MKR | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ZKKA, me partnerët ndërkombëtarë | Në vazhdimësi | OJF-të e KKSAT marrin mbështetje financiare të vazhdueshme për vijueshmërinë e shërbimeve | 15,000.0 | 15,000.0 | | |

**OBJEKTIV SPECIFIK: 2. (b) Garantimi i sigurisë fizike për të gjithë personat e trafikuar (VMT dhe VT)**

**TREGUESIT:** Ekzistenca e një plani për siguri individuale për të gjithë VMT dhe VT, ekzistenca e protokolleve të çështjes, me plane për mbrojtje individuale

| Nr. | Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto *(në mijëra lekë)* | Burimet e financimit *(në mijëra lekë)* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për fonde |
| 2.(b).1 | Garantim i mbrojtjes për të gjitha viktimat e mundshme të trafikimit dhe viktimat e trafikimit | PSH, AP<br>KKSAT | Në vazhdimësi | Përmbajtja e protokollit të çështjes: vlerësim individual i rrezikut dhe plane sigurie (për VMT dhe VT jashtë ose që duan të dalin nga streha)<br>Numri dhe përqindja e VMT që marrin mbrojtje të veçantë | 0.0 | | | |
| 2.(b).2 | Kryerja e vlerësimit të rrezikut para kthimit të VMT dhe VT në komunitetet e tyre, në përputhje me PSV-të | PSH/Drejtoritë e Policisë në qarqe, NJMF, Shërbimi Social Shtetëror Rajonal, Shërbimet sociale në bashki<br>AP, ASHMDF | Në vazhdimësi | Prania e vlerësimeve individuale të rrezikut dhe planeve të sigurisë | 1,114.2 | 1,114.2 | | |
| 2.(b).3 | Hartimi dhe zbatimi i planeve individuale të mbrojtjes për të gjithë personat e trafikuar të rritur/ të mitur (VMT dhe VT) jashtë strehave | PSH, Shërbimi Social Shtetëror Rajonal<br>Njësitë e Vetëqeverisjes vendore | Në vazhdimësi | Përmbajtja e protokolleve të rasteve<br>Raportet e policisë mbi masat e mbrojtjes | 668.520 | 668.520 | | |

| Nr. | Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto *(në mijëra lekë)* | Burimet e financimit *(në mijëra lekë)* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për fonde |
| | | NJMF/Shërbimet sociale në bashki | | | | | | |
| 2.(b).4 | Sigurimi i aksesit të të miturve, të vajzave, grave dhe meshkujve VT dhe VMT në varësi të nevojave, rikthim në shkolla, kurse profesionale, si dhe mbështetje për familjet e tyre | MFE/Qendrat e Formimit Profesional<br>AP<br>KKSAT<br>NJMF | Në vazhdimësi | Numri i VT/VMT që marrin formim profesional | 507.0 | 507.0 | | |
| 2.(b).5 | Sigurimi i punësimit të sigurt dhe afatgjatë dhe të ardhura të qëndrueshme për VT/VMT | MFE<br>AP<br>KKSAT<br>Biznesi privat | Në vazhdimësi | Numri i vt/vmt të punësuara | 960.0 | 960.0 | | |

**3. QËLLIMI STRATEGJIK:**

**Nxitja e kthimit dhe riintegrimit dhe përfshirjes sociale të të miturve dhe të rriturve si persona të trafikuar (VMT dhe VT) dhe ulja e rrezikut për personat e trafikuar për t'u riviktimizuar dhe ritrafikuar, ose që të kthehen në trafikues.**

**Treguesit:** Përqindja e personave të trafikuar të cilët kanë një punë dhe/ose një rrjet shoqëror një vit pas kthimit/rivendosjes në komunitet;

Numri dhe përqindja e personave të trafikuar të cilët janë trafikuar më shumë se një herë; numri dhe përqindja e trafikuesve të cilët janë trafikuar më parë;

Numri i viktimave të mundshme të trafikimit dhe viktimave të trafikimit të cilët janë kthyer në Shqipëri, dhe janë asistuar gjatë kthimit të tyre nga Shqipëria.

**OBJEKTIVI SPECIFIK: 3. (a) Nxitja e kthimit vullnetar të asistuar dhe riintegrimit të VMT dhe VT shqiptarë nga jashtë; dhe kthimi i personave të huaj të trafikuar**

**TREGUESIT:** Numri i viktimave të trafikimit të cilët janë kthyer në Shqipëri; përqindja e personave për të cilët është marrë njoftim paraprak dhe ekzistenca e planit të asistencës për pas- Kthimit dhe raporteve të progresit të riintegrimit.

Përqindja e viktimave të huaja të kthyer nga Shqipëria, të cilët kanë marrë asistencë për kthimin/riintegrimin.

| Nr. | Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto *(në mijëra lekë)* | Burimet e financimit *(në mijëra lekë)* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për fonde |
| 3.(a).1 | Zbatimi me rigorozitet i PSV-ve për kthim vullnetar të asistuar dhe riintegrim të VMT dhe VT shqiptarë nga jashtë vendit | MEPJ, MKR, AP, Strukturat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore/NJMF/Shërbimet | Në vazhdimësi | Numri dhe përqindja e VMT dhe VT (të rritur, të mitur) që janë asistuar në përputhje me PSV-të Numri dhe përqindja | 1,500.0 | 1,500.0 | | |

| Nr. | Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto *(në mijëra lekë)* | Burimet e financimit *(në mijëra lekë)* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për fonde |
| | | sociale në bashki, Partnerët, IOM<br>Terre des Hommes | | e rasteve ndërkufitare që përfshijnë njoftimet para kthimit, vlerësimet e riskut, plan sigurie (nëse kërkohet), plan asistence për riintegrimin pas kthimit vullnetar të asistuar, caktimi i menaxherit të rastit dhe raporte të rregullta mbi asistencën e marrë dhe procesin e riintegrimit. | | | | |
| 3.(a).2 | Garantimi i këshillimit, materialeve informuese, si dhe asistencë konkrete për qytetarët shqiptarë (personat e trafikuar ose në rrezik) jashtë vendit, nëpërmjet zyrave konsullore shqiptare | MEPJ/stafi konsullor, ZKKA, ON, OJF dhe aktorë të tjerë jashtë vendit | Në vazhdimësi | Numri i shqiptarëve jashtë që ka marrë këshillim, numri i VMT dhe VT shqiptare që janë asistuar jashtë vendit | 1,950.0 | 1,950.0 | | |
| 3.(a).4 | Zbatimi i PSV-ve për kthimin vullnetar të asistuar të VT/VMT të huaja në Shqipëri, dhe mbulimi i kostove të udhëtimit/riintegrimit | MEPJ, ZKKA, MKR, AP<br>IOM<br>Partnerët<br>Terre des Hommes | Në vazhdimësi | Numri dhe përqindja e VMT dhe VT të huaja të asistuara në përputhje me PSV-të<br>Disponueshmëria e fondeve<br>Mbulimi i kostove të udhëtimit për VT/VMT në kuadër të zbatimit të protokolleve bilaterale me Kosovën, Malin e Zi dhe Maqedoninë për identifikimin, njoftimin, referimin dhe kthimin vullnetar të asistuar të VT/VMT. | 1,350.0 | | | 1,350.0 |

**OBJEKTIV SPECIFIK 3. (b) Forcimi i programit për dhënien e asistencës afatgjatë me qëllim riintegrimin dhe përfshirjen shoqërore të të rriturve dhe të miturve që janë VMT dhe VT, në përputhje me nevojat individuale dhe PSV-të**

**Treguesit:** Numri dhe përqindja e VMT dhe VT që janë asistuar në përputhje me PSV-të; përmbajta e protokolleve të çështjes; Numri dhe përqindja e protokolleve të çështjes, përfshirë vlerësimin e riskut, planin e sigurisë, planin pas kthimit vullnetar të asistuar dhe asistenca për riintegrim, menaxheri përgjegjës për rastin dhe raporte të rregullta mbi menaxhimin e rastit lidhur me asistencën e marrë dhe procesin e riintegrimit

| Nr. | Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto *(në mijëra lekë)* | Burimet e financimit *(në mijëra lekë)* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për fonde |
| 3.(b).1 | Zbatimi me rigorozitet i PSV-ve për garantimin e asistencës për riintegrim, përfshirë monitorim dhe mbështetje afatgjatë, lehtësim aksesi për akomodim, | MSHMS/ASHDMF, SHSSH/DRSHSSH, NJMF, AP, ZKKA, MKR, | Në vazhdimësi | Numri dhe përqindja e aktorëve përkatës që kanë njohuri mbi PSV-të dhe përgjegjësitë e tyre (trajnimet e | 610.2 | 610.2 | | |

| Nr. | Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto *(në mijëra lekë)* | Burimet e financimit *(në mijëra lekë)* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për fonde |
| | këshillim, shërbime shëndetësore dhe ligjore, dhe punësim ose trajnim profesional;<br>Nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm dhe monitorimit | KRAT, dhe partnerët | | organizuara, manualet e përgatitura dhe të shpërndara)<br><br>Raportet e monitorimit | | | | |
| 3.(b).2 | Forcimi i programeve të riintegrimit për VMT dhe VT në qendra (si dhe qendrat për dhunën në familje, qendrat komunitare), përfshirë masat për të rritur mundësitë për punësim, këshillim, shërbime për punësim dhe asistim për vetëpunësim për VMT dhe VT | MSHMS/ASHDMF SHSSH, MKR, KRAT, Qendrat pritëse, pushteti vendor, me asistencë të ON dhe partnerëve | 2018-2020 | Forcimi i kapaciteteve të strehëzave për të ofruar mbështetje afatgjatë për riintegrim dhe për të rritur mundësinë e punësimit për VMT dhe VT | 11,700.0 | 7,020.0 | | 4,680.0 |
| 3.(b).3 | Krijimi i një Skeme Riintegrimi bazë me shërbime të specializuara për VMT dhe VT në nivel komuniteti, përfshirë akses të privilegjuar për strehim, shërbime shëndetësore dhe këshillim, ndihmë sociale/ekonomike, dhe për skema trajnimi profesional/aftësive jetësore<br><br>Pilotimi i modelit të shërbimeve riintegruese me bazë komunitare dhe mentorimit të VT/VMT | MSHMS, MFE, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, FISKSH, KRAT, veçanërisht Zyrat Rajonale të Punësimit, Qendrat e Trajnimit Profesional, pushteti vendor, Terre des Hommes dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë | 2018<br><br>2018-2019 | Ekzistenca e një pakete riintegrimi bazë, në përputhje me standardet e miratuara<br><br>Numri dhe përqindja e VMT dhe VT që përfitojnë nga këto paketa<br><br>Model i shërbimeve riintegruese komunitare dhe mentorimi për VT/VMT | 12,600.0 | 12,600.0 | | |
| 3.(b).4 | Forcimi i Bashkëpunimit ndër-institucional midis ofruesve të shërbimeve publike dhe jopublike në nivel lokal nëpërmjet krijimit të mekanizmave në nivel vendor për parandalimin, identifikimin, referimin dhe asistencën/mbrojtjen e VMT dhe VT.<br>Shkëmbimi i informacionit me ASHMDF për rastet e fëmijëve të identifikuar si VMT<br>Forcimi i rolit koordinues dhe monitorues i ASHMDF-së me strukturat e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijëve | Institucionet qendrore<br>Drejtoritë e Shërbimeve Sociale në Bashki<br>SHSSH,<br>ASHMDF/NJMF/PMF | Në vazhdimësi | Ekzistenca e një liste për ofruesit e shërbimeve dhe shërbimet<br>Numri i takimeve të rregullta të grupeve multi-disiplinore të koordinimit në nivel bashkiak, me pjesëmarrjen e të gjithë ofruesve të shërbimeve përkatëse | 1,114.2 | 557.1 | 557.1 | |
| 3.(b).5 | Informimi i VT dhe VMT për websitet dap.gov.al/vende-vakante/shpallje; shkp.gov.al. etj, si orientim mbi mënyrën e përdorimit të tyre. | MFE/SHKP<br>MSHMS<br>Task-Forca e MKR-së<br>KRAT<br>KKSAT | 2018 | Hartimi i raportit të monitorimit | 55.71 | 55.71 | | |
| 3.(b).6 | Rritja e aksesit të VT dhe VMT gra/vajza dhe meshkuj për të gjetur punësim në vende pune të | MFE/SHKP<br>MKR | 2018-2020 | Numri i VT/VMT të punësuar në sektorin publik | 5,557.5 | 5,557.5 | | |

| Nr. | Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto *(në mijëra lekë)* | Burimet e financimit *(në mijëra lekë)* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për fonde |
| | sektorit publik nëpërmjet rritjes së njohurive të tyre profesionale dhe orientimit tek kurset e formimit/shkollat profesionale. | KKSAT<br>AP | | | | | | |
| 3.(b).7 | Nxitja e aksesit të VT dhe VMT, gra, vajza, burra dhe djem për punësim në vende pune të sektorit privat. | MFE/SHKP<br>AP | 2018-2020 | Numri i VT/VMT të punësuar në sektorin privat | 4,320.0 | | 4,320.0 | |
| 3.(b).8 | Nxitja e aksesit të vajzave, grave, djemve dhe burrave VT dhe VMT në formimin profesional. | MFE/Qendrat e Formimit Profesional<br>AP<br>KKSAT | Në vazhdimësi | Numri i VT/VMT që marrin formim profesional | 493.2 | 493.2 | | |
| 3.(b).9 | Nxitja e punësimit të sigurt dhe afatgjatë dhe të ardhurave të qëndrueshme për VT/VMT (gra, vajza, burra dhe djem). | MFE/Qendrat e Formimit Profesional<br>AP<br>Biznesi social<br>KKSAT | Në vazhdimësi | Numri i VT/VMT në një punësim të sigurt | 409.5 | 409.5 | | |
| 3.(b).11 0 | Riintegrimi i meshkujve viktima/viktima të mundshme të trafikimit | MSHMS, Task-Forca e MKR-së, KRAT, KKSAT | 2019-2020 | Numri i meshkujve VT/VMT të riintegruara | 1,050.0 | 1,050.0 | | |

## PARANDALIMI

**1. SYNIMI STRATEGJIK:**
**Rritja e ndërgjegjësimit publik mbi të gjitha format e trafikimit të personave (trafikimi i brendshëm, shfrytëzimi për punë të detyruar të fëmijëve dhe të rriturve, lypja nga fëmijët etj.) si dhe pasojat e tij.**
**Treguesit:** Përqindja e popullsisë që kanë njohuri mbi fenomenin e trafikimit të personave, mund të përshkruajnë trafikimin e personave, mund të rendisin qëllimet kryesore për të cilat trafikohen njerëzit, pasojat sociale si dhe format klasike të rekrutimit; numri i rasteve të raportuara tek Linja Kombëtare 116006 dhe Aplikacioni "Raporto! Shpëto! dhe numri i rasteve që kanë raportuar tek shërbimet.

**OBJEKTIVI SPECIFIK: 1. (a) Rritja e ndërgjegjësimit mbi trafikimin e personave dhe pasojat e tij në përgjithësi, si dhe rritja e rolit të medias në parandalimin e trafikimit nëpërmjet ndërgjegjësimit publik**

**Treguesit:** Përqindja e personave që mund të përkufizojnë trafikimin e personave dhe që mund të rendisin format kryesore të trafikimit të personave, si dhe format kryesore të rekrutimit; hapat që duhet të ndiqen kur ka dyshime për TiP; numri dhe cilësia e njoftimeve mediatike mbi TP; numri i raportimeve nga publiku për dyshime në lidhje me trafikimin.

| Nr. | Veprimtari dhe nënveprimtari | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto *(në mijëra lekë)* | Burimet financiare *(në mijëra lekë)* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për fonde |
| 1.(a).1 | Kryerja e fushatave masive për rritjen e ndërgjegjësimit ndaj fenomenit të trafikimit, pasojat e tij, si dhe njohjen me të drejtat e viktimës së trafikimit<br>- 1 Spot ndërgjegjegjësues mbi TQNJ në radio & televizion<br>- Fushatë në media sociale<br>- Materiale ndërgjegjësuese të printuara | ZKKA, KRAT, MKR, AP, KKSAT, me të gjithë aktorët antitrafik<br>Terre des Hommes | Në vazhdimësi | Nr. i fushatave kombëtare të organizuara;<br>Numri i personave të informuar;<br>Nr. i materialeve informuese të shpërndara publikut në përgjithësi;<br>Prodhimi i spotit, fushatës në media sociale dhe materialeve ndërgjegjësuese | 3,225.0 | | | 3,225.0 |
| 1.(a).2. | Kryerja e trajnimeve/takimeve ndërgjegjësuese për gazetarët, mbi rolin e medias në parandalimin e trafikimit të personave/trafikimit të brendshëm, për të gjitha format e trafikimit të të rriturve apo fëmijëve (shfrytëzimi seksual, për punë të detyruar/skllavëri, lypje etj.) | ZKKA<br>MKR<br>AP<br>KKSAT<br>Shoqata e Gazetarëve<br>ON dhe partnerët | 2018 dhe në vazhdim | Numri i trajnimeve/takimeve për përfaqësuesit e medias së shkruar dhe vizive, numri i gazetarëve të trajnuar.<br>Numri dhe cilësia e artikujve të shtypit të shkruar. | 621.0 | | | 621.0 |
| 1.(a).3 | Mbajtja në funksionim 24 orë/7 ditë në javë e Linjës Kombëtare falas 116-006, dhe Aplikacionin "Raporto dhe Shpëto!, për të mundësuar raportimin e dyshimeve për TiP duke telefonuar nga linja fikse apo celularët.<br>Operatorët e linjës do të jenë të trajnuar dhe të kualifikuar; të jepen udhëzime për trajtimin dhe referimin e çështjeve, si dhe të promovohet Linja falas tek publiku. | MB/PSH/ZKKA<br>AP, OJF | Në vazhdimësi | Linja telefonike është funksionale 24/7, me staf të kualifikuar (trajnuar).<br>(Rritje e) numrit të telefonatave të marra nga qytetarët apo nga persona në rrezik apo të prekur nga trafikimi.<br>Përqindja e personave që ka njohuri dhe informacion mbi linjën telefonike falas. | 6,566.4 | 6,566.4 | | |
| 1.(a).4 | Mbështetja e Linjës Kombëtare me këshillim nga stafi i Qendrave të KKSAT me rotacion | MB/PSH/ZKKA<br>KKSAT AP, OJF | Në vazhdimësi | 50 punonjës të policisë që kanë marrë këshillim | 668.52 | 668.52 | | |
| 1.(a).5 | Vazhdimi i Fushatës Kombëtare të ndërgjegjësimit në Muajin Antitrafik *tetor* kundër të gjitha formave të trafikimit | MB, ZKKA, PSH, AP, SHSSH, KRAT, MKR, OJF, ON Terre des Hommes dhe partnere të tjerë ndërkombëtarë | Çdo tetor | Numri i personave të informuar | 3,360.0 | | | 3,360.0 |

| Nr. | Veprimtari dhe nënveprimtari | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto (*në mijëra lekë*) | Burimet financiare (*në mijëra lekë*) | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për fonde |
| 1.(a).6 | Bashkëpunimi me ASHMDF në kuadër të aktiviteteve të Planit të Veprimit për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Ekonomik dhe Fëmijët në Situatë Rruge 2018-2020 | ASHMDF, MKR, AP | Në vazhdimësi | Numri i aktiviteteve dhe pjesëmarrësve në to | 668.52 | 668.52 | | |
| 1.(a.)7 | Përfshirja e medias kombëtare dhe lokale në ndërgjegjësimin e komunitetit dhe transmetimin e spoteve me tematikë luftën kundër trafikimit të personave | ZKKA<br>Mediat kombëtare dhe lokale | Në vazhdimësi | Numri i emisioneve/reportazheve/spoteve të transmetuara<br>Numri i mediave të përfshira | 3,000.0 | 3,000.0 | | |

**OBJEKTIVI SPECIFIK: 1. (b) Rritja e ndërgjegjësimit të fëmijëve dhe të rinjve për trafikimin, shkaqet, rrethanat, rreziqet e pasojat e tij, si dhe trajtimi i temave mbi antitrafikimin të bëhet në kurrikulat bazë të institucioneve arsimore parauniversitare**

**TREGUESIT:** Numri (%) e shkollave (sipas llojit të shkollës), të cilat trajtojnë tema mbi "Trafikimin dhe parandalimin"; rritja e numrit (%) të stafit arsimor dhe të nxënësve (sipas llojit të shkollës/moshës) të cilët njohin konceptin trafikim, qëllimet e trafikimit, kushtet dhe mënyrat e rekrutimit, rrugët e parandalimit të tyre, si dhe parashikimet ligjore antitrafikim.

**SYNIMI:** Të paktën 90% e fëmijëve të shkollave të arsimit parauniversitar të marrin informacion ndërgjegjësues mbi antitrafikimin.

| Nr. | Veprimtari dhe nënveprimtari | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto (*në mijëra lekë*) | Burimet financiare (*në mijëra lekë*) | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për Fonde |
| 1.(b).1 | Përfshirja e edukimit antitrafikim në kurrikulat e arsimit parauniversitar, kryesisht në kurrikulën e lëndës "Qytetaria" si dhe në orët e lira apo edukative.<br>Trajnim i vazhdueshëm i stafit mësimor, i drejtuesve, i mësuesve, i shërbimit psiko-sociale (psikologë, punonjës socialë) dhe i mjekëve në shkolla, për tema që kanë lidhje me konceptin trafikim, qëllimet e tij, kushtet dhe mënyrat e rekrutimit, rrugët e parandalimit të tyre si dhe parashikimet ligjore antitrafikim. | MASR/Drejtoritë Arsimore Rajonale, KRAT | 2018 -2020 | Tema mbi antitrafikun të përfshira në kurrikulat e të gjitha shkolla para-universitare<br>Numri dhe përqindja e personelit shkollor dhe e fëmijëve në moshë shkollore (në të gjitha nivelet përkatëse) të cilët kanë njohuri mbi fenomenin e TiP, rreziqet dhe shkaqet e tij, kontaktet e nevojshme për të sinjalizuar dhe për të marrë ndihmë. | 981.0 | 90.0 | | 891.0 |
| 1.(b).2 | Organizim i diskutimeve/takimeve me komunitetin në shkolla mbi trafikimin e personave me përfshirjen e aktorëve antitrafikim | DAR/ZA/Mësuesit, Psikologu-punonjësi sociale/<br>KRAT?TT<br>SHSSH<br>NJMF<br>DVP | 2018 -2020 | Numri i takimeve në shkolla/ klasë me aktorë përgjegjës për antitrafikimin | 1,604.448 | 1,604.448 | | |

| Nr. | Veprimtari dhe nënveprimtari | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto *(në mijëra lekë)* | Burimet financiare *(në mijëra lekë)* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për Fonde |
| | | KKSAT | | | | | | |
| 1.(b).3 | Infomimi i komunitetit, të rinjve, nxënësve e mësuesve në shkolla lidhur me legjislacionin kombëtar dhe me Konventat Ndërkombëtare Antitrafikim | ZKKA<br>MKR<br>KKSAT<br>partnerët | Në vazhdimësi | Numri i personave të informuar | 1,604.448 | 1,604.448 | | |

**OBJEKTIVI SPECIFIK 1. (d): Rritja e ndërgjegjësimit të punonjësve të sistemit shëndetësor mbi kontributin e specialistëve të shëndetit në lidhje me identifikimin fillestar, asistencën shëndetësore dhe referimin e VT/VMT.**
**TREGUESIT:** Numri dhe përqindja e punonjësve të sistemit shëndetësor, të cilët kanë njohuri mbi TiP dhe dinë çfarë të bëjnë në rast se dyshojnë për TiP; numri i viktimave të mundshme dhe rasteve të mundshme të TP të cilat janë referuar.

| Nr. | Veprimtari dhe nënveprimtari | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto *(në mijëra lekë)* | Burimet financiare *(në mijëra lekë)* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për fonde |
| 1.(d).1 | Rritja e ndërgjegjësimit dhe informimit të stafit të punonjësve të sistemit shëndetësor për TiP, nëpërmjet materialeve informuese dhe trajnimeve në të 12 qarqet mbi trafikimin e personave, bazuar në manualin e përdorimit të PSV-ve, si dhe detyrimet që rrjedhin nga Paketa Bazë e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor (planifikuar të rishikohet brenda 2018), mbi masat për identifikimin fillestar dhe referimin e rasteve të mundshme të trafikimit (të rritur e fëmijë) gjatë ofrimit të kujdesit shëndetësor për:<br>- Ofruesit e Kujdesit Shëndetësor Parësor (përfshirë konsultorin e nënës dhe fëmijës) si detyrim nga paketa e rishikuar ;<br>- Ofruesit e kujdesit shëndetësor në urgjenca në zbatim të manualeve të përdorimit të PSV-ve;<br>- Ofruesit e kujdesit të specializuar në shëndet mendor në zbatim të manualeve të përdorimit të PSV-ve | MSHMS<br>ZKKA,<br>MKR<br>AP | Në vazhdimësi | Numri dhe përqindja e profesionistëve, të cilët janë të trajnuar dhe i kuptojnë rolet e tyre si aktorë aktivë në përpjekjet për parandalimin e trafikimit të personave (të rritur e fëmijë).<br>Numri i referimeve të viktimave të mundshme të trafikimit dhe të rasteve të mundshme të TP. | 807.0 | 807.0 | | |

| Nr. | Veprimtari dhe nënveprimtari | Strukturat përgjegjëse (struktura kryesore në fillim) | Afati | Treguesit/synimet | Kosto *(në mijëra lekë)* | Burimet financiare *(në mijëra lekë)* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Institucionet shtetërore | Donatorët | Nevoja për fonde |
| 1.(d).2 | Përfshirja e elementëve të trafikimit në Paketën Bazë të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor (paketë mbi të cilën lidhet kontrata me ofrues të kujdesit shëndetësor parësor) si një mekanizëm për të siguruar kontribut proaktiv të profesionistëve shëndetësore të Kujdesit Shëndetësor Parësor në lidhje me parandalimin, identifikimin dhe referimin e trafikimit të personave, si dhe nevojën për të pasur njohuritë/aftësitë e duhura për ta bërë këtë gjë. | MSHMS | 2018-2020<br>Brenda 2018 | Paketën Bazë të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor e rishikuar me parashikime të reja mbi rolin/përgjegjësinë e tyre si aktorë aktivë në parandalimin e TiP (të rritur e fëmijë) gjatë ushtrimit të detyrave të tyre të përditshme. | 366.0 | 366.0 | | |
| 1.(d).3 | Monitorimi i zbatimit të detyrimit të punonjësve të sistemit shëndetësor për të raportuar mbi identifikimin dhe referimin e trafikimit të personave | MSHMS | Në vazhdimësi | Numri i raportimeve | 1,604.448 | | | 1,604.448 |
| 1.(d).4 | Kryerja e fushatave ndërgjegjësuese në bashkëpunim me grupet/personat që punojnë me viktima të mundshme të trafikimit, gjithë aktorët që mund të hasin indikatorë të trafikimit të personave tek grupet apo personat në rrezik (përfshihen njësitë e mbrojtjes së fëmijëve, shërbimet psiko-sociale në shkolla, njësitë kundër dhunës në familje dhe për asistencë sociale, zyrat e punës etj.)<br>Informim i shtresave në nevojë për fenomenin e trafikimit të personave nëpërmjet aktivitete të Qendrave Komunitare Multifunksionale | MSHMS<br>ZKKA, MKR, AP, NJMF, KRAT, OJF<br>KKSAT<br>ON<br>Terre des Hommes | Në vazhdimësi | Përqindja e njerëzve që punojnë me grupet e "viktimave të mundshme" dhe të cilët mund të përshkruajnë trafikimin e personave (format e rekrutimit, shfrytëzimit etj.), treguesit e TP, si dhe mënyrat e identifikimit (nëpërmjet njohjes së treguesve dhe udhëzuesve për intervistimet) dhe të referimit sipas nevojës.<br>Përqindja/ numri i personave të informuar me anë të fushatave ndërgjegjesuese | 3,360.0 | 3,360.0 | | |
